



UNIVERSITETI I EJL
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike
The Faculty of Public Administration and Political Sciences
Факултетот за јавна администрација и политички науки

STUDIMET POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA: Liria e shprehjes në Kosovë

Kandidati:
Rron Zajmi

Mentori:
Prof. Agron Rustemi

Tetovë, Maj, 2019

Përmbajtja

Lista e shkurtesave:	5
Abstrakti	7
Hyrje	9
Liria e shprehjes	12
Mbrotjtja ndërkombëtare	13
Karta e të drejtave themelore të Bashkimit European	13
Konventa Europiane për të drejtat e njeriut	14
Karta për të drejtat civile dhe politike	14
Deklarata universale për të drejtat e njeriut	14
3 Maji – Dita ndërkombëtare për lirinë e medias	15
Mekanizmat	15
Rastet e trajtuara nga Gjykata Europiane për të drejtat e njeriut	16
Korniza ligjore në Kosovë	21
Kufizimet e lirisë së shprehjes dhe shpifja	23
Institucioni i Avokatit të Popullit	25
Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM)	26
Komisionet e kuvendit të Republikës së Kosovës	26
Këshilli i Mediave të Shkuara të Kosovës	27
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGPK)	27
Sistemi i drejtësisë	29
Gjykata kushtetuese	29
Rasti Nr. KI 38/09	30
Rastet Nr. KI 27/12, KI31/12, KI 32/12 dhe KI33/12	30
Rasti nr. KI61/15	31
Rasti KI13/16	32
Rasti KI130/16	33
Rasti KI116/17	34
Zhvillimet e fundit dhe raporte të ndryshme vendore	35
Qytetarët besojnë se mediat gëzojnë lirinë e shprehjes, mediat si krijues të opinioneve	35
Avokati i popullit	36
Ushtrimi i profesionit të gazetarisë	36
Emisioni Drejtësia në Kosovë	37

Hapësira publike, si mundësi për liri të shprehjes	37
Mungesa e ligjit specifik që trajton lirinë e shprehjes.....	38
E drejta e qasjes në dokumente publike vlerësohet pozitivisht	39
Ligji për sinjalizuesit konsiderohet hap pozitiv	40
Mungesa e sindikatës së gazetarëve	43
Sulmet ndaj gazetarëve	44
Sistemi i drejtësisë dhe organet e sigurisë përballë gazetarëve.....	47
Iniciative për ligj të ri për Media dhe bashkëpunimi me prokurorinë	49
Lajmet e rreme, fenomen global që ka ndikuar edhe te ne	50
Raportet Ndërkombëtare	53
Department of State – Human Rights	53
Freedom House	54
Human Rights Watch	55
Progress Report.....	55
Reporters without borders	55
Transparency International.....	56
Vendet e rajonit	57
Shqipëria	57
Maqedonia	58
Turqia	59
Suedia	60
Përmbledhje dhe rekomandime	61
Bibliografia	68
Legjislacioni:	68
Webfaqe:	69
Libra, buletin dhe aktvendime:	70
Raporte:	72

Lista e shkurtesave:

AP	Avokati i Popullit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi European
BIRN	The Balkan Investigative Reporting Network
ÇOHU	Organizatës për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet
EC	Emancipimi Civil ma Ndryshe
FB	Facebook
GJEDNJ	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
HRW	Human Rights Watch
INDEP	Instituti per Politika Zhvillimore
KCSF	Fodacioni Kosovar për Shoqëri Civile
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KMSHK	Këshilli i Mediave të Shkruara
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KPMK	Keshillit të Pavarur Mbiqyres per Sherbimin Civil te Kosoves
KTV	Kohavision
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim e Europës
PD	Partia Demokratike
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PS	Partia Socialiste
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RTV21	Radio Televizioni 21
RWB	Reporters without borders
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TI	Transparency International
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNESCO	Organizata e kombëve të bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (United Nations European Science

USAID	Agjensioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar
YIHR	Youth Initiative for Human Rights

Fjalët kyqe: liria e shprehjes, media, demokracia, te drejtat e njeriut, gazetarë.

Abstrakti

Siç mund të kuptohet edhe nga tituli i punimit “Liria e shprehjes në Kosovë” ky hulumtim tenton të analizoj dhe jap shpjegime sa i përket nivelit të respektimit të drejtës së lirisë së shprehjes në Kosovë dhe mundësitë që kanë qytetarët për të shfrytëzuar këtë drejtë. Punimi fokusohet në punën e gazetarëve dhe mediave si një platformë kyçe që i shërben dhe kontribuon kësaj të drejte. Sa i përket metodologjisë së hulumtimit, janë përdorur disa metoda siç janë: metoda deskriptive – përshkrim deskriptiv i problematikës, teorive e nocioneve kryesore që lidhen me temën; metoda statistikore – paraqitje e të dhënave të ndryshme statistikore e empirike që vlerësojnë lirinë e shprehjes; metoda e analizës – analizë e thellë e raporteve, fakteve, kornizës ligjore dhe mendim autorial për secilën prej tyre, metoda e krahasimit – krahasim në mes të Kosovës dhe vendeve të rajonit e më gjërë në lidhje për problematikën;

Gjetjet kryesore të hulumtimit janë se Kosova e gëzon një kornizë të përshtatshme ligjore sa i përket lirisë së shprehjes dhe ushtrimit të profesionit të gazetarisë apo punës së medieeve. Ajo çka është shqetësuese mbetet zbatimi dhe respektimi në praktikë i këtij legjislacioni. Puna e gjykatave dhe e institucioneve të drejtësisë e policisë mbetet jo shumë e kënaqshme kur është fjala për lirinë e shprehjes, megjithatë ka përmirësime gjatë viteve të fundit. Mediat dhe gazetarët mbeten shpeshherë cak i sulmeve të ndryshme nga persona fizik e juridik, duke mos përjashtuar edhe institucionet publike. Vlerësimet nga raporte të ndryshme ndërkombëtare radhisin Kosovën dhe rajonin në përgjithësi si vende gjysmë të lira dhe me nivel mesatar të respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi, lirinë e shprehjes në veçanti.

Konsideroj se punimi pas analizës së shumë raporteve dhe gjendjes aktuale ofron rekomandime të qarta për institucione të caktuara dhe shoqërinë në tërësi. Puna e sistemit të drejtësisë duhet të jetë më efikase në çështjet e të drejtave të njeriut. Duhet të promovohen sa më shumë të drejtat e njeriut dhe shoqëria të edukohet dhe vetëdijësohet në lidhje me rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe lidhjen e tyre me nivelin e demokracisë. Gazetarët dhe mediumet duhet të vazhdojnë punën e tyre investigative dhe kërkesat e

vazhdueshme për respektim të punës së tyre. Të vazhdohet të promovohen rastet e suksesit të shpërfaqjes së keqpërdorimeve të ndryshme publike.

Duke qenë një problematike mjaft aktuale dhe e rëndësishme jo vetëm për Kosovë por edhe vendet në mbarë botën, secili punimi shtesë që trajton këtë fushë jep një kontribut të rëndësishëm. Si i tillë shpresoj se edhe ky hulumtim me tërësinë e saj do të ndihmoj të jap një perspektivë interesante të respektimit të kësaj të drejte në Kosovë dhe disa rekomandime të rëndësishme që mund ti ndjekin institucionet relevante për përmirësim të gjendjes aktuale. Shtesë, ky punim mund ti shërbej edhe në të ardhmen të gjithë atyre që dëshirojnë të merren me analizimin e të drejtave të njeriut, lirisë së shprehjes apo edhe punës së mediave e gazetarëve në Kosovë.

Hyrje

Brenda periudhës tetëmbëdhjetë vjeçare, nga viti 1999 deri në vitin 2018, Kosova ka rrugëtuar nëpër procese të ndryshme zhvillimi, gjatë së cilës periudhë ka pësuar ndryshime të mëdha juridike dhe politike. Në vitet e para të pasluftës ishin institucionet e përkohshme vetqeverisëse dhe autoritetet ndërkombëtare që kujdeseshin për mbarëvajtjen e funksionimit të Kosovës së lirë. Zgjedhjet e para lokale të vitit 2000¹ dhe ato parlamentare të vitit 2001² do të jenë momentet e fillimit të rrugëtimit institucional të Kosovës së pasluftës. Në vitin 2008 Kosova do të shpall pavarësinë e saj³, e cila do të njihet ndërkombëtarisht nga mbi 100 shtete, ndër to edhe shtetet më të rëndësishme perëndimore. Ndërtimi i institucioneve, lufta kundër korrupsionit, forcimi i demokracisë ishin disa nga sfidat të cilat e përçollën vendin tone që nga viti 2008. Shumë prej këtyre problemeve vazhdojnë të jenë sfida edhe në ditët e sotme.

Të drejtat e njeriut cilësohen si njëra ndër shtyllat kryesore të funksionimit të demokracisë. Në shumë raste, niveli i demokracisë në një vend matet pikërisht me nivelin e respektimit të të drejtave të njeriut. Si e tillë kjo fushë ka gëzuar vëmendje të shtuar nga institucionet dhe partnerët ndërkombëtar gjatë gjithë këtyre viteve. Kjo punë dhe ky angazhim do të zhvillohej në dy dimensione, në njërën anë puna në legjislacion që ishte më pak sfiduese, ndoshta edhe për shkak të adaptimit kryesisht të legjislacioneve ekzistuese të vendeve të Bashkimit Europian (BE), dhe pjesa tjetër në drejtim të respektimit dhe trajtimit të këtyre ligjeve në praktikë. Kjo e fundit vazhdon të mbetet një sfida e vazhdueshme për institucionet dhe shoqërinë kosovare.

Ndër të drejtat kryesore dhe me shumë rëndësi vlerësohet të jetë edhe e drejta e lirisë së shprehjes, si një ndër të drejtat themelore dhe esenciale të një shoqërie demokratike. Sipas konventës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut liria e shprehjes perkufizohet si: “Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së

¹ <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-komunale-2000>, qasur më 15/02/2019

² <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-e-pergjithshme>, qasur më 15/02/2019

³ Deklarata e pavarësisë së Kosovës - http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Dek_Pav_sh.pdf

informacionit dhe ideve me çfarëdo mjatesh, pa marrë parasysh kufijtë”⁴. Pra nëse e analizojmë lirinë e shprehjes në përkufizim e saj sipas kësaj konvente ajo nuk paraqet medoemos vetëm lirinë për të shprehur apo folur e paraqitur mendimet por edhe të drejtën për të menduar, pa ndërhyrje dhe të drejtën për të marrë dhe pranuar informacion. Që në tërësinë e saj të gjitha këto kontribuojnë në lirinë e individit për tu shprehur.

Derisa karta për të drejtat civile dhe politike, lirinë e shprehjes e përkufizon si: “Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij”⁵. Kjo kartë në krahasim me konventën ndërkombëtare e thellon dhe detajizon edhe për një nivel marrjen dhe përhapjen e informacioneve duke i paraqitur edhe format e marrjes dhe përhapjes së informacioneve.

Kosova vazhdon të kaloj nëpër sfida mjaft të rëndësishme dhe ekzistenciale si shtet, ndër to pa dyshim vlerësohet të jetë edhe respektimi i të drejtave të njeriut. Raportet e shumta vendore dhe ato ndërkombëtare e radhisin Kosovën në pozitë jo shumë mira sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut dhe një vend me një demokraci të brishtë. Respektimi i të drejtave të njeriut lë shumë për të dëshiruar, pavarësisht përparimeve dhe investimeve me vite të tëra që janë bërë në këtë fushë.

Pikërisht të qenit njëra ndaj problemeve kryesore të Kosovës është edhe arsyeja e perzgjedhjes për të hulumtuar një temë të tillë dhe për të ofruar një perspective tjetër, e rekomandime të cilat mund të kontribuojnë sado pak në këtë problematikë tejet serioze. Struktura e hulumtimit është e ndërtuar asisoji që gjatë leximit të plotësoj informatat në mënyrë hierarkike. Kapitulli i parë tenton të familjarizoj lexuesin në mënyrë të përgjithshme me të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes. Këtu, duke ofruar përkufizimet kryesore ndërkombëtare sa i përket kësaj të drejte dhe mekanizmat ndërkombëtarë të cilët sigurojnë respektimin dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Kapitulli i dytë ofron një pasqyrë dhe analizë të kornizës ligjore në Kosovë. Cilat janë ligjet të cilat prekin respektimin e lirisë së shprehjes, në cilat raste mund të cenohet ajo edhe me ligj dhe çka përmban liria e medias dhe si rregullohet ajo në Kosovë?.

⁴ Konventa Universale për të drejtat e njeriut, Gjakata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Europës, Strasbourg, https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf qasur më 10/01/2019

⁵ Karta për të drejtat civile dhe politike.

Informata në lidhje me sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe institucionet të cilat mbrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes shpjegohen në kapitullin e tretë të këtij punimi. Për shpjegim më të mirë në këtë kapitull trajtohen edhe disa raste të rëndësishme të cilat janë shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e që lidhen me pretendimet për shkeljen e lirisë së shprehjes.

Kapitulli i katërt i këtij punimi trajton raportet dhe vlerësimet e institucioneve vendore, shtetërore dhe ato të shoqërisë civile dhe mediave të ndryshme në lidhje me këtë problematikë. Gjithashtu pjesë e këtij kapitulli janë edhe zhvillimet e fundit kryesore në drejtim të lirisë së shprehjes në Kosovë. Derisa, në kapitullin e pestë trajtohen raportet kredibile ndërkombëtare për Kosovën, gjithmonë në raport me lirinë e shprehjes, me fokus në media. Për të pas një bazë më të mirë të vlerësimit por edhe trendeve në disa raste do të krahasohen edhe trendet e dy-tre viteve të fundit.

Një analizë e njejtë e situatës sikurse e Kosovës por e fokusuar në vetëm disa dimensione kryesore do të ofrohet edhe për vendet e rajonit si Maqedonia dhe Shqipëria, kjo në kapitullin e gjashtë të punimit.

Në fund të punimit bazuar në analizën e bërë dhe të gjeturat nga raportet dhe plotësimi i disa anketave do të ofrohen rekomandime konkrete për përmirësimt që mund të bëhen në këtë fushë. Nga një rekomandim për secilin institucion relevant dhe përgjegjës për respektim të kësaj të drejte. Në fund të punimit si aneks mund të gjenden edhe tabela dhe grafikone të ndryshme të cilat e përshkruajnë dhe vizualizojnë pjesën përmbajtësore të këtij punimi.

Sa i përket metodologjisë së punës, punimi përfshinë metodat deskriptive, metoda statistikore, metoda të analizës, metoda të krahasimit dhe metoda të anketimit. Përveç analizës së dokumenteve dhe fakteve, në punim do të paraqiten edhe informata nga anketa me persona të cilët në mënyrë direkte ose indirekte preken nga kjo problematikë. Si e shohin ata lirinë e shprehjes në Kosovë? A mund lirisht qytetarët e Kosovës ti shprehin mendimet e tyre? A cenohet liria e shprehjes, a ka censurë në media?. Një vend të rëndësishëm në punim zë edhe trajtimi i rasteve të cilat kanë të bëjnë me cenim të lirisë së shprehjes, kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe censurimit në media. Sa kallëzime penale janë ngritur, sa ankesa i kanë shqyrtuar organet kompetente dhe për sa prej tyre është marrë vendimi?.

Në përgjithësi punimi tenton të ofroj një pasqyrë reale të gjendjes së lirisë së shprehjes në Kosovë nga këndvështrime të ndryshme dhe rekomandime konkrete në lidhje me përmirësimin e gjendjes së respektimit të kësaj të drejte.

Liria e shprehjes

Liria e shprehjes përkufizohet si njëra ndër të drejtat themelore dhe më të rëndësishme të njeriut. Kjo edhe për faktin se ka ndërlidhje edhe me shumë të drejta të tjera dhe rrezikimi apo cenimi i lirisë së shprehjes cenon edhe të drejtat e tjera të njeriut por edhe nivelin e demokracisë në përgjithësi. Termi "liria e shprehjes" është mjaft i gjerë. Ai përfshin lirinë e fjalës dhe të medias, por edhe lirinë e mendimit e edhe atë intelektual. Liria e shprehjes do të thotë mundësi për tu shprehur lirshëm, për të kritikuar autoritetet publike, për të shpërfaqur padrejtësitë, për të paraqitur korupsionin, për të treguar për keqpërdorimet zyrtare, për të thënë atë që mendon lirshëm pa pretenduar se dikush mund të të ndëshkoj ose gjykoj për atë. Marrja edhe dhënia e informacionit është gjithashtu liri e shprehjes.

Sa i përket zhvillimit historik të lirisë së shprehjes ajo është zhvilluar krahas dhe me të drejtat e tjera. Mendimet e dijetarëve sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut kanë filluar shumë herët. Poeti dhe dramaturgu Euripides (480-406 p.l.k) do të mbahet mend për shprehjen e tij "Kjo është liria e vërtetë, kur burrat e lindur të lirë, të cilët duhet të këshillojnë publikun, mund të flasin lirë"⁶. Ndërsa John Milton poeti anglez, në linjë me lirinë e shprehjes do të shprehej "Mbi të gjitha liritës, më jepni lirinë për të ditur, për të thënë dhe për të argumentuar lirisht sipas ndërgjegjes".

Në formën më të sofistikuar të organizimit shoqëror, shtetin, jemi mësuar të dëgjojmë zakonisht për tri pushtetet e ndara e që janë: pushteti legjislativ, ai ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor. Megjithatë në këtë kohë të globalizmit dhe avancimit të madh teknologjik e paisjeve të reja gjithnjë e më shumë po diskutohet për mediat dhe rolin e saj në shoqëri. Jo rastësisht media cilësohet edhe si pushteti i katërt. E gjithë kjo falë ndikimit të madh që kanë dhe ushtrojnë mbi shoqërinë në përgjithësi e në qeverisje të vendit në veçanti. Duke marrë parasysh këtë fakt dhe rëndësinë e medias në lirinë e shprehjes i është dhënë edhe fokusi më i madh në këtë hulumtim.

⁶ <http://www.azquotes.com/quote/872994> qasur më 29/04/2018

Së pari mediat kanë për detyrë që të shpërndajnë informacion, dhe të informojnë publikun për zhvillimet shoqërore e politike. Kjo ju jep pastaj mundësi atyre që edhe të krijojnë qëndrimet dhe opinionet e tyre për fenomene të caktuara. Raportimi i drejtë i tyre në lidhje me ngjarjet, kontribuon edhe në funksionimin e drejtë të demokracisë dhe luftimin e dukurive të kqija e përgjegjshmërinë e institucioneve publike. Gazetarët duhet të jenë të lirë dhe të ju respektohet e drejta e lirisë së shprehjes si dhe të ju garantohet një ambient sa më i favorshëm i punës.

Mbrojtja ndërkombëtare

Liria e shprehjes trajtohet në disa nene të dokumenteve dhe rregulloreve ndërkombëtare të cilat janë bërë edhe pjesë të mbrojtjeve kushtetuese të shumicës së vendeve në botë, thënë ndryshe shtetet zotohen se do të mbrojnë dhe respektojnë të drejtat e njeriut bazuar në konventat ndërkombëtare. Gjithashtu kushtetutat dhe ligjet respektive për çështjen e të drejtave të njeriut janë në përpuethshmëri me konventat ndërkombëtare, më poshtë janë të paraqitura disa nga dokumentet me të rëndësishme ndërkombëtare të cilat përkufizojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut.

Karta e të drejtave themelore të Bashkimit European

Në dhjetor të vitit 2000, institucionet e Bashkimit European (Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni European) do të proklamojnë Kartën e të drejtave themelore të Bashkimit European. Qëllimi ishte që të drejtat, e zhvilluara në kohë dhe forma të ndryshme në vende të ndryshme të përmbledhen dhe figurojnë në një dokument të vetëm. Në asnjë formë kjo kartë nuk zëvendëson Konventën për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, madje është në përputhje dhe harmoni të plotë me të. Ajo vetëm se forcon dhe në një formë me eksplicite i proklamon të drejtat.

Karta përbëhet prej shtatë kapitujve dhe preambulës. Ajo trajton: dinjitetin, liritë, barazinë, solidaritetin, të drejtat e qytetarëve, drejtësinë dhe dispozita të përgjithshme për interpretim të kartës. Fuqinë ligjore, kartës themelore do t'ia jap Traktati i Lisbonës, i cili hyri në fuqi me 1 dhjetor të vitit 2009. Liria e shprehjes dhe e informimit trajtohet në nenin 11 të kësaj karte dhe aty decidivisht thuhet: “Kushdo ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit si edhe të drejtën për të marrë e për të dhënë informacion

dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë si dhe liria dhe pluralizmi i medias respektohen”⁷.

Konventa Europiane për të drejtat e njeriut

Në Romë, në vitin 1950 shtetet anëtare të Këshillit të Europës ranë dakord dhe nënshkruan Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Asokohe, konventa kishte 59 nene, ndërsa gjatë viteve në vazhdim do të rishikohej dhe plotësohej me protokolle shtesë. Në kuadër të kapitullit të I-rë trajtohen edhe të drejtat dhe liritë e njeriut, ndësa konkretisht në nenin 10-të të konventës trajtohet edhe liria e shprehjes, ku kjo e drejtë në këtë dokument të rëndësishëm përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ndërkohë që në kuadër të nenit respektiv parashihen edhe detyrimet, përgjegjësitë por edhe kufizimet dhe sanksionet eventuale të cilat janë të nevojshme dhe në interes të shteteve.⁸

Karta për të drejtat civile dhe politike

Karta për të drejtat civile dhe politike përbëhet nga gjashtë pjesë dhe 53 nene. Ajo hyri në fuqi në vitin 1976. Ngjashëm sikurse te karta themelore e të drejtave edhe në kartën për të drejtat civile dhe politike liria e shprehjes garantohej, përfshinë lirinë e kërkimit marrjes dhe përhapjes së ideve dhe informacionit dhe njëkohësisht u nënshtrohet disa kufizimeve dhe ndalesave të cilat aplikohen në rastet kur cenohen të drejtat e të tjerëve apo për arsye të sigurisë kombëtare.

Deklarata universale për të drejtat e njeriut

Pasojat nga lufta e dytë botërore do të lindin nevojën e iniciativës për promovimin dhe mbrojtjen më të madhe të të drejtave të njeriut. Një iniciativë e cila do të mbledhte një komision me anëtarë nga shtete të ndryshme të cilët përfaqësonin kultura të ndryshme. Puna e këtij komisioni do të rezultonte me një dokument i cili është ndër më të rëndësishmit në fushën e të drejtave të njeriut. Deklarata do të miratohej nga Asambleja e Përgjithshme e

⁷ Official Journal of the European Union C 326/391 EN, 26.10.2012,

⁸ European Convention on Human Rights – European Court of human Rights & Council of Europe

Kombeve të Bashkuara e cila edhe do ti jepte mbështetjen e duhur institucionale dhe do të merrte trajtën globale e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo deklaratë përbëhet nga 30 nene/artikuj. Liria e shprehjes trajtohet në kuadër të Nenit 19-të, dhe atë si vijon: “Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë”⁹.

3 Maji – Dita ndërkombëtare për lirinë e medias

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e lirisë së shprehjes, respektimit të obligimeve të shtetit në raport me deklaratën universale për të drejtat e njeriut, konkretisht nenin 19, data 3 Maj është caktuar si dita botërore e lirisë së mediave. Kjo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara¹⁰. Në vende të ndryshme të botës kjo ditë shënohet në mënyra të ndryshme, duke organizuar tryeza të ndryshme shkencore, marshe, protesta, performance artistike, etj.¹¹

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) në nderim të kësaj dite, çdo vit që nga viti 1997 me 3 Maj, ndan çmimin ndërkombëtarë për liri të mediave. Ky çmim nderon personat, organizatat ose institucionet për kontributin e tyre në mbrojtje dhe promovimi të lirisë së mediave kudo në botë. Çmimi mban emrin e Guillermo Cano Isaza, redaktorin e të përditshmës El Espectador, i cili u vra më 17 dhjetor 1986 në Bogota. Përzgjedhja e fituesit bëhet nga një juri profesionale prej 18 personave. Çmimi për vitin 2018 i është ndarë fotoreporterit egjiptian Mahmoud Abu Zeid¹².

Mekanizmat

Përveç anës ligjore dhe konventave me të cilat mbrohen të drejtat e njeriut janë edhe një sërë mekanizmesh dhe institucionesh të cilat mbrojnë apo punojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këto institucione janë organizata qeveritare dhe joqeveritare. Në nivel global Kombet e Bashkuara janë institucioni më i lartë i cili njëri nga objektivat e tyre ka

⁹ Deklarata Universale e të drejtave të njeriut,

https://www.un.org/en/udhrbook/pdf/udhr_booklet_en_web.pdf, qasur më 03/03/2019

¹⁰ https://en.wikipedia.org/wiki/World_Press_Freedom_Day - shfletuar më 05/06/2018.

¹¹ <http://www.indiacelebrating.com/events/world-press-freedom-day/> - shfletuar më 05/06/2018

¹² <https://en.unesco.org/prizes/guillermo-cano> - qasur më 05/06/2018

edhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në vitin 1948-të, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka adoptuar Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë fokusi do të jetë te disa mekanizma të tjerë kryesisht në Europë.

Europa ka një sistem mjaft të zhvilluar kur është fjala te të drejtat e njeriut, me disa organizata të cilat janë përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Nga ato më të rëndësishmet janë Këshilli i Europës, Unioni European dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim (OSCE) si institucioni shumë i rëndësishëm e cila shtrin punën e saj edhe në disa shtete të cilat nuk mbulohen nga sistemet tjera regjionale¹³. Neni 19-të i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut parasheh krijimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila u krijua në vitin 1959-të.

Qëllimi i gjykatës është që të bëj monitorimin e respektimit të deklaratës. Selia e gjykatës është e vendosur në Strasburg të Francës. Aktualisht numri i gjyqtarëve në GJEDNJ është 47. Ky numër përfaqëson edhe numrin e shteteve anëtare. Janë dy forma apo mundësi të aplikimit dhe parashtrimit të ankesave në Gjykatë. E para, çdo shtet anëtarë mund të i drejtohet GJEDNJ-së për çfarëdo pretendimi të ndonjë shkelje të dispozitave të konventës nga ndonjë shtet tjetër anëtar (GJEDNJ, neni 33). Ndërsa mënyra e dytë është aplikimi individual i cili pranohet nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë se të drejtat e tyre sipas Konventës ndërkombëtare dhe protokollet e saj janë shkelur nga një shtet anëtar (Neni 34)¹⁴. Ndër organet kryesore të gjykatës janë: Gjykata plenare dhe dhomat e gjykatës. Kryetarët e dhomave të gjykatës zgjidhen nga anëtarët e gjykatës plenare.

Kosova meqë nuk është anëtare e Këshillit Europës nuk i lejohet dërgimi i rasteve në gjykatën europiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ)¹⁵.

Rastet e trajtuara nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut

Më poshtë do të paraqiten disa raste të trajtuara nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e që kanë të bëjnë me ankesat në lidhje me shkeljen e nenit të 10-të të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e që ka të bëjë me lirinë e shprehjes. Gjatë vitit

¹³ Mayrhofer, M. et al., 'International Human Rights Protection: Institutions and Instruments', (2014) FRAME Deliverable 4.1, available at <http://www.fp7-frame.eu/wp-content/uploads/2016/08/02-Deliverable-4.1.pdf>

¹⁴ Ibid

¹⁵ Registry of the European Court of Human Rights Re: Ask For, Message to Rron Zajmi, May 2018, Email.

2018, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka realizuar gjithsejtë 1,014 raste. Nga këto raste, 77 kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes. Nga vendet e rajonit, vetëm Republika e Maqedonisë ka paraqitur një rast në këtë gjykatë. Në vijim janë shpjeguar dy raste raste ku është vërtetuar shkelja e lirisë së shprehjes dhe një tjetër ku Gjykata ka konsideruar se nuk ka pasur shkelje të kësaj të drejte¹⁶.

Rasti i parë ku është konsideruar se ka pas shkelje është rasti i gazetarit Şahin Alpay kundër Republikës së Turqisë (aplikacioni numër 16538/17). Gazetari Şahin Alpay, i cili punonte për të përditshmen turke Zaman, gazetë kjo online, e cila u mbyll nga qeveria në vitin 2016 atëherë kur u organizua edhe “puçi” ndaj presidentit Erdogan. Gazetari Şahin Alpay u arrestua me pretendimin se në shkrimet e tij informative apo edhe opinionet personale kishte kritikuar qeverinë. Ai gjithashtu u etiketua edhe si një përkrahës i lëvizjes së Fetullah Gulenit. Prokurori i rastit kishte kërkuar dënim maksimal deri në burgim të përjetshëm për z.Alpay.

Aplikanti kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me shkeljet e pretenduara ndaj tij. Kjo Gjykatë herën e parë refuzon të jap opinion për rastin në fjalë, megjithatë në Janar të vitit 2018-të do të konstatoj që ka pasur shkelje nga Gjykata e Themelore dhe kërkon që të lirohet nga paraburgimi gazetari Alpay. Përkundër që vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë obligative dhe kjo Gjykatë kishte shpërndarë vendimin e saj, Gjykata e 13-të dhe e 14-të e Apelit të Stambollit do të refuzoj lirinë e gazetarit, duke u thirrur në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe trajtimin e lëndëve individuale nga ana e kësaj Gjykate. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese do të rikonfirmoj vendimin e saj me datën 1 Shkurt të vitit 2018-të.

Shtesë, gjatë muajit shkurt gazetari Alpay do ti drejtohej edhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Me datë 15 Mars 2018-të, disa ditë para vendimit të GJND-së, Gjykata Themelore do të ndërroj masën e arrestit për gazetarin duke e vendosur në arrest shtëpiak dhe duke ja ndaluar daljen nga shteti. Vendimi i GJND-së do të përkrahte z.Alpay dhe vendimin kushtetues duke konsideruar se opinionet e tij nuk paraqitnin asnjë argument se mund të ishte pjesë e ndonjë grupi të caktuar apo edhe se rezikonin Republikën e

¹⁶ List of cases recommended by the Juriscounsel and approved by the Bureau, European Court of Human Rights, Strasbourg, March 2019.

Turqisë. Shtesë, gjykimi i një gazetari vetëm për bindjet e tij është shkelje e rëndë e lirisë së shprehjes¹⁷.

Rasti i dytë të cilin do ta paraqes është një vendim i gjykatës i cili kishte konsideruar se gjykata kombëtare nuk ka bërë shkelje ndaj ankuesit dhe ka vlerësuar se vendimi i gjykatës në fjalë ka qenë në përputhje me respektimin e konventës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, specifikisht nenin 10-të të kësaj konvente. E gjithë ngjarja do të ndodhte në seminare falas, publike, të organizuara dhe përkrahura nga partia e ekstremit të djathtë, Partia e Lirisë për votuesit e saj të ri. Në këto seminare do të ligjëronte edhe E.S e cila ndër të tjera do të fliste edhe për islamin¹⁸.

Në seminarin ku do të flitej për islamin, ajo ndër të tjera, flet edhe për profetin Muhamed a.s, të cilin e akuzon se ishte martuar me një vajzë të re dhe kjo mund të interpretohej edhe si pedofili. Në këtë seminar, rastësishëm kishte marrë pjesë edhe një gazetar i cili e kishte dëgjuar ligjërimin e E.S dhe pastaj e kishte botuar në gazetë. Marrë shkas nga kjo policia dhe prokuroria e kishin kontaktuar E.S dhe e kishin akuzuar për nxitje të urrejtjes fetare dhe e kishin dënuar me gjobë në vlerë prej 480 euro me arsyetimin se kishte nënçmuar doktrinat fetaret.

Duke konsideruar se i ishte shkelur e drejta e lirisë së shprehjes, E.S parashtroi ankesë në gjykatat e shkallëve më të larta me shpresë se do të rëzonin vendimin e gjykatës së I-rë. Megjithatë, edhe gjykatat e tjera kishin vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe konfirmuar dënimin. Duke mos gjetur “përkrahjen” në gjykatat kombëtare, shtetasja E.S do të kërkonte interpretimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke konsideruar se po i shkelet e drejta e saj për liri të shprehjes dhe se ajo kishte shprehur vetëm mendimin e saj dhe se ishte bazuar në jetën që thuhet se e kishte bërë profeti.

Gjykata Europiane e Drejtësisë, unanimisht do të vendoste në favor të gjykatave të Austrisë duke konsideruar se nuk kishte pasur shkelje të lirisë së shprehjes, meqë deklaratat nuk i kishin kontribuar në asnjë mënyrë debatit publik dhe limitet që parasheh shteti Austriak në lirinë e shprehjes lidhen me potencialin për të shkaktuar trazira dhe ofenduar e

¹⁷ Case of Sahin Alpay v. Turkey (Application no.16538/17) European Court of Human Rights, Strasbourg, 20 March 2018

¹⁸ <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=caselaw/reports&c=>, qasur më 28/04/2019

provokuar liritë fetare¹⁹. Ky vendim gjithsesi se ka ngjallur pastaj shumë debat publik në mesin e njohësve dhe mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut nëse mund të konsiderohej i drejtë vendimi i GjND-së, për shkak se shumë njerëz të tjerë mendonin se E.S nuk kishte bërë asgjë më shumë se shprehje të mendimit të saj.

Rasti i tretë dhe i fundit i trajtuar në këtë pjesë ka të bëjë sërish me një vendim “pozitiv” të gjykatës ku vlerësohen shkelje nga gjykatat kombëtare. Rasti në fjalë lidhet me mediat dhe punën e gazetarëve në përgjithësi. Gjatë një udhëtimi për të përcjellur një ndeshje futbolli në mes të Rumanisë dhe Hungarisë, disa tifoz hungarez do të ndaleshin para një shkolle në të cilën vijonin mësimet nxënës të komunitetit rom. Ata kishin filluar të i fyenin dhe ofendonin ata, madje edhe kishin sulmuar me shishe dhe thuhet se njëri nga tifozët kishte kryer edhe nevoja fiziologjike para ndërtesës. Vetëm intervenimi i policisë kishte bërë që situata të qetësohej.

Menjëherë pas ngjarjes kishte reaguar edhe një përfaqësues nga komuniteti rom duke e dënuar ngjarjen dhe duke bërë lidhje në mes të agresorëve dhe një partie politike hungareze, specifikisht partinë Jobbik. Ai këto deklarata do ti bënte për një media lokale. Intervista e tij do të ngarkohej në platformën online youtube. Pas një dite një medium tjetër, përmes platformës së tyre online 444.hu do të publikonte një lajm në lidhje me ngjarjen dhe në fund të këtij shkrimi do të ngarkonte edhe linkun me intervistën e dhënë nga përfaqësuesi i komunitetit rom. Në asnjë moment në shkrimin e portalit nuk do të citohej intervista madje as nuk ishte bërë asnjë lidhje në mes të grupit të tifozve dhe partisë politike, e vetmja çështje që do të bëhej problematike në këtë rast do të ishte linku.

Të indinjuar nga intervista dhe përhapja mediale që po i bëhej lajmit, partia Jobbik do të ngriste padi ndaj portalit duke e akuzuar se kishte bërë shpërndarje të një interviste të paverifikuar nga ana e tyre, e që në thelb kjo intervistë akuzonte partinë e tyre pa bazë dhe lidhshmëritë që kishte me grupin e tifozve. Gjykata do të shpallte fajtor portalin, duke konsideruar se shpërndarja e lajmeve të paverifikuara është e dënueshme dhe se nuk kishte ndonjë fakt të lidhshmërisë së partisë politike dhe tifozëve. Përkundër apelineve të këtij vendimi, duke pretenduar se i ju është shkelur e drejta e lirisë së shprehjes, portali nuk do të

¹⁹ Case of E.S. v. Austria (Application no.38450/12) European Court of Human Rights, Strasbourg, 25 October 2018

gjente ndonjë mbështetje kombëtare para se të i drejtohej Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Me datë 4 dhjetor 2018, GJND-ja do të silte vendimin ku do të konsideronte se në rastin në fjalë kishte pasur shkelje të lirisë së shprehjes dhe se nuk mund të gjykohej portali dhe gazetari për shkak të shpërndarjes së një linku të vetmë. GJND-ja do të konstatonte se gjykatat vendore nuk kanë marrë parasysh tërë rastin dhe të gjitha rrethanat. Liria e shprehjes në vetvete parasheh edhe të drejtën për dhënien dhe marrje të informacionit. Andaj, sipas gjykatës nuk mund të dënohet portal i cili vetëm e ka dhënë një link, duke mos bërë asnjë koment shtesë dhe ndërlidhur videon me tekstin e mësipërm²⁰.

²⁰ Case of Magyar Jeti ZRT v. Hungary (Application no.11257/16), European Court of Human Rights, Strasbourg, 04/12/2019.

Korniza ligjore në Kosovë

Respektimi i të drejtave të njeriut gjenë vend si kategori kushtetuese në disa nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës²¹. Ajo hyri në fuqi në datën 15 Qershor 2008-të. Deri në atë kohë Kosova ishte duke u qeverisur nga korniza kushtetuese e cila bazohej në Rezolutën 1244²² e cila ishte miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e 4011-të, më 10 Qershor të vitit 1999-të. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka gjithsejtë 66 faqe, 14 kapituj dhe 162 nene. Në të rregullohen dispozitat themelore; të drejtat dhe liritë themelore; të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre; struktura, kompetencat dhe mandati i kuvendit, qeverisë, presidentit, sistemit të drejtësisë, gjykatës kushtetuese; marrëdhëniet ekonomike, qeverisja lokale dhe organizimi territorial; sektori i sigurisë; institucionet e pavarura; dispozitat përfundimtare dhe ato kalimtare.

Të drejtat e njeriut janë të rregulluara me kushtetutë në kuadër të kapitullit të II-të “Të drejtat dhe liritë themelore” me gjithsej 36 nene²³. Ndërkohë me kapitull të veçantë, kapitulli i III-të rregullohen “Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”²⁴. Para se të shohim kapitujtë e veçantë kur rregullohen të drejtat e njeriut duhet të përmendim edhe dispozitat themelore, konkretisht paragrafin 2 të nenit 1 ku përmendet ushtrimi i autoritetit të Republikës së Kosovës duke u bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj. Gjithashtu në kuadër të Kapitullit të I-rë, tek dispozitat themelore edhe në kuadër të neneve “Barazia para ligjit”, “Vlerat” përmendet respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe përkushtimi i shtetit për tu përkujdesur për këto të drejta²⁵.

²¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi më 15 qershor 2008 - <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

²² <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Res1244ALB.pdf>

²³ <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

²⁴ Ibid.

²⁵ Ibid.

Në kuadër të kapitullit të II-të “Të drejtat dhe liritë themelore” rregullohen parimet e përgjithshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Është shumë e rëndësishme të theksohet se në kuadër të nenit 22 përmendet se të drejtat e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të përmendura, gjithsej 8-të, garantohen edhe me kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike. Nëse shohim këtë listë të dokumenteve mund të thuhet se janë përfshirë dokumentet dhe konventat kryesore europiane dhe ndërkombëtare të cilat i rregullojnë të drejtat dhe liritë e njeriut²⁶.

Nëse i referohemi specifikisht të drejtës së Lirisë së Shprehjes ajo në kushtetutë rregullohet si “Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush”²⁷. Ndërsa gjithashtu me nenin 42 garantohet edhe liria dhe pluralizmi i medieve. Sipas këtij neni, censura është e ndaluar, askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve²⁸. Pra, edhe Liria e shprehjes por edhe ajo e medieve është e garantuar me kushtetutë dhe këto të drejta mund të kufizohet vetëm sipas nenit 55-të, ku thuhet se të drejtat dhe liritë e njeriut mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

Ndërsa një kufizim tjetër përmendet edhe në nenin pasardhës që është ai 56, nen ky i cili rregullon të drejtat dhe liritë themelore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme²⁹. Të gjitha këto në kuadër të Kushtetutës së Kosovës. Liria e shprehjes dhe ajo e medias (liria e informimit) rregullohet edhe përmes ligjeve të caktuara dhe atë përmes ligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), ligji për qasje në dokumente publike³⁰. Aspekti kushtetues dhe ligjor patjetër që duhet të ketë edhe institucionet të cilat janë gardianë apo mbikqyrës të respektimit të këtyre të drejtave. Disa

²⁶ Kushtetuta e Kosovës, Kapitulli II, Neni 22 <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

²⁷ Ibid, Neni, 40.

²⁸ Ibid, Neni, 42.

²⁹ Ibid, Neni 55 dhe Neni 56

³⁰ 2015, INDEP, Liria e shprehjes dhe ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë: analizë krahasimore e kornizës ligjore – Burim Ejupi, Dardan Abazi – Prishtinë.

prej tyre janë agjensi dhe institucione në kuadër të institucioneve qeverisëse ndërsa disa si institucione të pavarura.

Kufizimet e lirisë së shprehjes dhe shpifja

Përkundër se liria e shprehjes synohet të mbrohet dhe të promovohet si e drejtë që duhet të garantohet dhe mbrohet në shumicën e rasteve, kemi raste kur ajo në disa vende edhe kufizohet. Kufizimi i saj konsiderohet se mund të jetë pozitiv dhe në disa raste mund të të parandaloj ndonjë të keqe tjetër më të madhe. Në disa shtete liria e shprehjes nuk kufizohet fare pavarësisht rethanave apo situatave, derisa në disa shtete për arsye e shkaqe të caktuara ajo kufizohet. Në Kosovë, kushtetuta e vendit në nenin ku parasheh mbrojtjen e lirisë së shprehjes, flet edhe për kufizimin e saj. Sipas saj, liria e shprehjes mund të kufizohet në rastet kur mund të nxis apo provokoj dhunë në baza fetare, etnike, idologjike, etj³¹.

Megjithatë, në këtë pjesë do të trajtohet një dimension tjetër i pasojave që mund të shkaktoj edhe “pakufizimi” ose “keqpërdorimi” i lirisë së shprehjes. Është krijuar një kuptim se njeriu mund të shpreh çfarëdo dhe për këdo të flas në emër të lirisë shprehjes. Mirëpo kur kjo liri e shprehjes e humb kuptimin e vërtetë edhe mund të ketë pasoja në rast se nuk trajtohet si duhet. Sidomos në raste kur ajo mund të keqpërdoret në drejtim të ndonjë personi tjetër ose institucioni për shpifje dhe fyerje.

Në emër të po kësaj lirie të shprehjes mund të shkaktohen dëme materiale dhe jomateriale, dëme të reputacionit për të tjerët. Në shumë dokumente e qarqe shpifja përkufizohet si lajm jo i vërtetë, gënjeshtër, që mund të shkaktoj dëme të pariparueshme të pala tjetër. Këto shpifje mund të bëhen në formë të shkruar ose mund të thuhet gojarisht. Është gjithashtu një debat i gjërë që ndodh në gjithë botën, në lidhje me atë nëse shpifja dhe fyerja duhet të konsiderohen si vepra penale apo civile. Disa mendojnë se trajtimi i shpifjes dhe fyerjes si vepra penale mund të parandaloj që të ndodhin në të ardhmen apo njerëzit mund të kenë edhe më shumë kujdes para se të pretendojnë për ndonjë shpifje

³¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf, qasur më 30/04/2019

publike për shkak të pasojave eventuale. Derisa, një pjesë tjetër e konsideruar më liberale konsideron se trajtimi i këtyre kategorive si vepra penale mund të cenoj lirinë e shprehjes.

Njerëzit do të ndihen të frikësuar të flasin opinione të cilat mund të mos jenë në tërësi të vërteta apo edhe të shtjerrin shumë kohë e cenzurojnë pjesë të caktuara para se të shprehin opinion. Në Kosovë shpifja, rregullohet përmes ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes³². Ky ligj përveq shpifjes, parasheh edhe rastet e fyerjes, kur ato konsiderohen se janë të dënueshme, përjashtimet, imunitetin dhe kompensimin. Decidivisht në këtë ligj, shpifja përkufizohet si: *“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër”*.

Në një raport të organizatës joqeveritare YIHR “State of Constriction”³³ në një seksion të veçantë analizohet ndikimi i shtetit por edhe i partive politike mbi medime të caktuara. Organizata në raport vlerëson se mediumi Klan Kosova, favorizon Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), kjo e bazuar në hapësirën mediale që i ofrohet përfaqësuesve të kësaj partie. Organizata vlerëson se panelistë pro kësaj partie më shumë se të tjerët janë prezent nëpër emisione ku edhe kanë shfaqur favorizime për PDK-në, sidomos gjatë kohës së zgjedhjeve lokale. Ndërkohë që pronari i televizionit, Baton Haxhiu, e konsideron si shpifje raportin dhe pretendon se ky raport i ka shkaktuar dëm të reputacionit, meqë raporti në fjalë i është ndarë medieve të ndryshme dhe faktorit ndërkombëtar.

Më 24 Qershor të vitit 2010-të pronari i televizionit Baton Haxhiu padit organizatën YIHR në Gjykatën Themelore në Prishtinë duke pretenduar për shpifje, ku i kërkon edhe dëmshpërblim në vlerë prej 300,000.00 eurosh. Dëshmitë e tyre në gjykatë i kishin dhënë edhe autorët e raportit në atë kohë por edhe drejtoresha dhe stafi menaxhues i organizatës. Megjithatë vendimi i gjykatës themelore do të jetë në favor të organizatës. Gjykata nuk ka arritur në asnjë moment që të vërtetoj pretendimet e paditësit se është shkaktuar ndonjë dëm material televizionit në fjalë por edhe vendimin e tyre e kanë bazuar në nenin 8 të ligjit, ku trajtohet pjesa e opinionit. Në këtë rast pjesa e pretenduar për shpifje ka qenë opinion i autorit i cili megjithatë në atë përfundim ka ardhur pas një vlerësimi të disa “fakteve”.

³² Ligji Civil kundër shpifjes dhe fyerjes nr. 02/L-65, 01.05.2008, qasur më 26/12/2018

³³ Youth Initiative for Human Rights (YIHR), STATE OF CONSTRICTION? Governance and Free Expression in Kosovo, 24 Maj 2010, Prishtinë

Në tjetër kufizim i lirisë së shprehjes është edhe fyerja e cila në ligjin e sipërmendur përkufizohet si “Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese”. Pra për dallim nga shpifja, këtu nuk kemi të bëjmë me jo të vërteta por me qëllimin në vetvete. Kjo do të ishte edhe një fitore e lirisë së shprehjes dhe motiv për organizatat e tjera që të vazhdojnë me hulumtime të ndryshme investigative.

Institucioni i Avokatit të Popullit

Përveç institucioneve të sistemit të drejtësisë të sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe nuk lejojnë shkeljen e tyre, madje edhe ndëshkojnë ata që shkelin këto parime, kemi edhe një institucion të pavarur e që është Avokati i Popullit (AP). I ndarë nga ndikimi i pushteteve, AP mbetet institucioni i vetëm i pavarur ku qytetarët dhe të gjithë ata që pretendojnë që kanë pasur shkelje të të drejtave të tyre të drejtohen me ankesë. Ky institucion sigurohet që të mbroj dhe të promovoj të drejtat dhe liritë e njeriut, qofshin ata persona fizik apo juridik karshi institucioneve apo autoriteteve publike.

Gjithashtu ky institucion merret edhe me parandalimin e tortures dhe sigurohet që personave të privuar nga liria mos të i mohohen dhe shkelen të drejtat. Gjithashtu të sigurohet se ata nuk do të torturohen gjatë procesit të arrestimit, paraburgimit apo edhe qëndrimit në institucione “mbajtëse”. Të gjitha kompetencat dhe puna e funksionimi i këtij institucioni rregullohet përmes ligjit të veçantë³⁴. Nëse i referohemi kushtetutës së Kosovës, roli i Institucionit të Avokatit të Popullit përkufizohet si: mbikëqyrës dhe mbrojtës i të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike³⁵.

Kuvendi i Kosovës bën zgjedhjen e avokatit të popullit. Mandati i kësaj pozite është 5 vjeçar, dhe ai/ajo që ushtron këtë pozitë njëherë nuk mund të rizgjedhet sërish. Mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i zëvendësve brenda këtij institucioni rregullohet me Ligjin për Avokatin e Popullit. Ky institucion jo vetëm në rastet e ankesave të palëve për shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e organeve shtetërore, por edhe me vetiniciativë mund të propozoj masa dhe bëj rekomandime nëse vëren shkelje nga autoritetet publike³⁶. Shtesë,

³⁴ Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, 26.06.2015, qasur më 13/07/2018

³⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XII, Neni 132

³⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XII, Neni 135

Avokati i popullit në pajtim me kushtetutën dhe dispozitat e saj mund të drejtor çështje edhe në Gjykatën kushtetuese, si institucioni më i lartë i mbrojtjes së kushtetueshmërisë së vendit³⁷.

Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM)

Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM) është një organ i pavarur i cili është themeluar në vitin 2005. Ligi për Komisionin e Pavarur të Mediave përcakton kompetencat e këtij institucioni. Të gjithë personat fizik ose juridik të cilët ofrojnë shërbime audio ose vizuale i nënshtrohen të drejtave përgjegjëse dhe detyrimeve të cilat mbikqyren nga KPM-ja. Për misionin dhe punën e KPM-së lidhet me spektrin e frekuencave të transmetimit në Kosovë, i cili bën rregullimin dhe menaxhimin e këtyre frekuencave³⁸. Pavarësia e këtij institucioni është e përcaktuar me kushtetutë³⁹. Gjatë punës së saj KPM-ja duhet të sigurohet se puna e saj është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të transmetimit dhe standardet e të drejtave të njeriut. Shtesë, legjislacioni përkatës i BE-së si në shumë raste të tjera duhet të merret parasysh por në rastin e KPM-së ajo duhet të ketë parasysh në veçanti Direktivën e Komisionit Evropian AVMS⁴⁰.

Komisionet e kuvendit të Republikës së Kosovës

Me qëllim të organizimit dhe menaxhimit sa më të mirë dhe efikas të punës Kuvendi i Kosovës themelon trupa punues të cilat i quan komisione. Meqë koha gjatë seancave plenare nuk siguron kohë të mjaftueshme dhe kualitative për punë ky forum konsiderohet si formë e mirë e organizimit. Të gjitha çështjet të cilat ju referohen nga Kuvendi, obligohen që të shqyrtohen nga komisionet, meqë rast përparatit edhe rekomandimet dhe opinionet e ndryshme⁴¹.

³⁷ Ibid

³⁸ <http://www.kpm-ks.org/?faq=90&guha=1>

³⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XII, Neni 141

⁴⁰ Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 9

⁴¹ Doracak Organizimi dhe Funksionimi i Komisioneve Parlamentare, Xh. Hoxha, Sh. Haxhijaj, L. Ymeri, F. Hyseni, A. Ademaj, R. Beka, Sh. Kastrati, Prishtinë, Maj 2010

Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione është komision funksional i cili përbëhet prej 10 anëtarëve. Gjatë vitit 2016 ky komision ka mbajtur gjithsej 16 mbledhje dhe 3 dëgjime publike ndërsa gjatë vitit 2017 ka mbajtur 11 mbledhje⁴². Komisioni për të Dretat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione edhe Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media është komision funksional i cili përbëhet prej 11 anëtarëve⁴³.

Këshilli i Mediave të Shkuara të Kosovës

Në shtator të vitit 2005, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim e Europës (OSBE) ndihmon themelimin e një trupi vetrregullues që do të quhej Këshilli i Mediave të Shkuara të Kosovës (KMSHK). Ky trup do ti shërbej ekskluzivisht sektorit të mediave në Kosovë të cilët edhe do të jenë themelues të këtij organi. Ky Këshill ka edhe një kod etik i cili është edhe baza mbi të cilin funksionon. Qëllimi i KMSHK-së është që të mbroj fjalën e lirë, të siguroj respektimin e kodit etik dhe vetrregullimin e mediave. Shtesë KMSHK tenton që përmes punës së saj dhe respektimit të kodit do të arrij standardin që qytetarin të mbroj nga shpifjet apo shkrimet e pavërteta në njërin anë ndërsa në anën tjetër të mbroj edhe gazetarët nga ankesat e pambështetura⁴⁴.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGPK)

Gazetarët në Kosovë kanë një shoqatë të tyre e cila është Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), organizatë joqeveritare e regjistruar në Prishtinë. Synimi dhe qëllimi i kësaj organizate është që të kontribuoj dhe të përmirësoj ambientin në të cilin punojnë gazetarët dhe të përmirësoj gazetarinë kualitative. Mundësia e anëtarësimit në këtë shoqatë është hapur si mundësi për të gjithë gazetarët në Kosovë. Aktualisht kjo organizatë konsiderohet si një adres kryesore ku gazetart mund të paraqesin shqetësimet e tyre por edhe iniciativa të ndryshme për avokim.

Si Asociacion, AGK-ja mundohet që nëpërmjet hulumtimeve të ndryshme, avokimit dhe rrjetëzimit me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të avansoj pozitën e gazetarëve në Kosovë dhe të ngris zërin për problemet që i ka ky komunitet. AGK-ja është

⁴² www.votaime.org

⁴³ <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,147>

⁴⁴ <http://presscouncil-ks.org>, qasur më 01/12/2018

anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve. Përveç kësaj, AGK-ja vazhdimisht kontribuon në ngritjen profesionale të gazetarëve nëpërmjet trajnimeve, aktiviteteve të rrjetëzimit dhe informimit të brendshëm për komunitetin e gazetarëve. Shtesë, Asociacioni vitin e fundit ka filluar punën edhe me një databazë e cila edhe i dokumenton të gjitha sulmet ndaj gazetarëve. Tutje, Asociacioni organizon takime të rregullta me institucionet e ndryshme në vend dhe lobon e avokon për përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët dhe krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për ta.

Sistemi i drejtësisë

Sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës rregullohet me kushtetutë, saktësisht në kapitullin e VII-të dhe me ligjin e veçantë për gjykatat, Ligji nr.03/L-199. Sipas ligjit për gjykatat struktura organizative e gjykatave përbëhet nga: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme⁴⁵. Ndërkohë Gjykata Kushtetuese është e rregulluar me ligjin për gjykatën kushtetuese⁴⁶. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është organ mbikëqyrës dhe misioni është që të krijohet dhe të ruhet një sistem gjyqësor kosovar i pavarur⁴⁷.

Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur, me autoritet dhe me përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është e rregulluar me ligj. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit. Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj⁴⁸.

Gjykata kushtetuese

Organi më i lartë gjyqësor në Kosovë është Gjykata Kushtetuese e cila merret me interpretimin e kushtetutës së Kosovës dhe trajton rastet në të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me kushtetutë. Gjykata kushtetuese përbëhet nga nëntë gjykatës dhe funksionimi i saj është i rregulluar me ligjin për gjykatën kushtetuese. Selia e gjykatës kushtetuese është në Prishtinë. Gjykata kushtetuese nuk inicon vet shqyrtim të rasteve por ato duhet vetëm të parashrohen nga persona të autorizuar dhe në mënyrë ligjore.

Sa i përket rasteve të individëve ata pasi ti kenë shterur të gjitha mundësitë e tyre ligjore, përmes gjykatave dhe instrumenteve të tjera mund ti drejtohen gjykatës

⁴⁵ Ligji për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199

⁴⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf, qasur më 12/12/2018

⁴⁷ Këshilli Gjyqësor i Kosovës – webfaqja zyrtare, qasur më 05/06/2018

⁴⁸ Webfaqja zyrtare e prokurorit të shtetit, www.psh-ks.net qasur më 05/06/2018

kushtetuese për shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre nga autoritetet publike. Më poshtë janë të paraqitura disa nga rastet e ngritura në gjykatë kushtetuese ku kontestohet edhe shkelja e lirisë së shprehjes, e garantuar me kushtetutë të Republikës së Kosovës.

Rasti Nr. KI 38/09

Rasti në fjalë trajton pretendimet e një radio lokale për shkeljen e të drejtave të njeriut, ndër të tjera edhe asaj të shprehjes nga një autoritet publik, e që në këtë rast është Komisioni i Pavarur i Mediave (tutje KPM). Kërkesa e dorëzuar në gjykatë kushtetuese specifikisht kërkon interpretimin e gjykatës në lidhje me vendimin e gjykatës Supreme të datës 12 Shkurt 2009. Radio Sharri kishte marrë licensë nga KPM në lidhje me transmetimin e sinjalit në një lokacion të caktuar gjeografik, megjithatë pas një kohe kjo radio për shkak të “force majeure” kishte ndërruar lokacionin e saj dhe transmetimin, pa e njoftuar paraprakisht KPM-në. Me të pranuar informacionin se radio nuk ishte duke respektuar vendimin e këtij komisioni, ata do të marrin vendim që të i konfiskoj radio transmetuesit sinjalin, pas një sërë tentimeve të dështuara për të arritur ndonjë marrëveshje me operatorin Radio Sharri.

Duke konsideruar se ky veprim i KPM-së kishte shkelur të drejtat e njeriut, duke përfshi edhe lirinë e shprehjes, radio i është drejtuar gjykatës themelore në Kaçanik dhe pas refuzimit të kësaj të fundit u janë drejtuar gjykatës kushtetuese. Pra, pasi i kanë shterur të gjitha mundësitë ligjore, ata i drejtohen gjykatës kushtetuese, ashtu siç parashihet me ligj. Rasti i paraqitur atakon pikërisht këtë vendim, mirëpo gjykata kushtetuese e hedh poshtë për shkak të mos respektimit të afatit kohor⁴⁹.

Rastet Nr. KI 27/12, KI31/12, KI 32/12 dhe KI33/12

Rastet në fjalë janë parashtruar ndaras nga katër persona dhe janë trajtuar nga gjykata kushtetuese. Të gjitha rastet janë nga persona individë të cilët kontestojnë dy vendime të gjykatave, atë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë dhe një Aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut në Pejë. Kërkesa është parashtruar së pari nga Mykyreme Hoxha, me datë 19 Mars 2012, duke u pasuar nga kërkesat e Merita Hoxha dhe Mërgim Hoxha, të dorëzuara më 26 Mars 2012, për tu përmbyllur me parashtruesin e katërt Blerim Hoxha. Në

⁴⁹ Radio Zeri i Sharrit kunder Vendimit A. nr. 2194/07 të Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 12 shkurt 2009, Ref. Nr. RK53/10, Vendim për papranueshmëri, 15 Tetor 2010, Prishtinë

objektin e lëndës së tyre ata pretendojnë se është ju është shkelur edhe liria e shprehjes së tyre, megjithatë kjo jo se është arritur të artikulohet si duhet në ankesën e parashtruar. Rasti ka të bëjë me një blerje të një prone të paluajtshme nga i ndjeri M.H ndaj H.D, meqër ast H.D konsideron se asaj i ishte bërë e padrejtë ku i është marrë banesa e saj gabimisht meqë sipas pretendimeve të saj kishte egzistuar marrëveshje për ndërtim të përbashkët dhe jo marrëveshje të shitblerjes.

Gjykata Komunale në Pejë i jep të drejtë H.D-së duke detyruar trashëgimtarët e të ndjerit M.H që ti kthejë pronën H.D-së. Pas këtij aktvendimi të gjykatës komunale, familja H. i drejtohet Gjykatës së Qarkut për të kontestuar vendimin e gjykatës komunale. Megjithatë sikurse gjykata komunale edhe ajo e qarkut vendos në favor të H.D-së duke hedhur poshtë pretendimet e familjes. Pasi i janë shterur të gjitha mundësitë ligjore, ata i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Përfundimisht, Gjykata kushtetuese e hedh poshtë si të pabazuar kërkesën e tyre për shkak se konsiderojnë se nuk janë ofruar dëshmi dhe fakte të mjaftueshme se si gjykatat paraprake i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut⁵⁰.

Rasti nr. KI61/15

Cenim të të drejtave të njeriut nga autoritetet publike, pretendon edhe rasti nr. KI61/15 i parashtruesit Islam Krasniqi. Në rastin në fjalë parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë në aktgjykimin e e gjykatës së Apelit të Kosovës, A.A, nr.2/2014 të muajit shkurt 2014. Pretendimet e parashtruesit janë se vendimi i gjykatës, komisioneve disiplinore dhe punëdhënesit, Ministria e Punëve të Brendshme, i kanë shkelur të drejtat themelore të tij duke përfshirë edhe lirinë e shprehjes, kufizim të drejtave dhe lirive të njeriut, të mbrojtura këto me kushtetutë. Parashtruesi i kërkesës kishte krijuar marrëdhënie pune me Ministrinë e Punëve të Brendshme në muajin shkurt të vitit 2010-të.

Pas një kohe, punëmarrësi ishte akuzuar nga mbikqyrësit dhe kolegët për sjellje jo të hijshme dhe performancë të dobët në punë. Me gjithë këto vërejtje, punëmarrësi nuk kishte treguar ndonjë përmirësim në punën e tij. Për këtë shkas Komisioni Disiplinor në kuadër të Ministrisë kishte marrë vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ndaj Islam Krasniqit.

⁵⁰ Mykyreme Hoxha, Merita Hoxha, Mergim Hoxha dhe Blerim Hoxha Vleresim i kushtetutshmerise se aktgjykimit te Gjykates Komunale ne Peje, C. 90/03 te 09.01.2008, dhe te Aktgjykimit te Gjykates se Qarkut ne Peje, AC Nr. 313/2010 te 09.11.2011, Ref. Nr. RK438/13, Vendim për papranueshmëri 5 Korrik 2013, Prishtinë.

Pas këtij vendimi të komisionit, parashtruesi i kërkesës do të ankohet mbi këtë vendim në një komision tjetër që është ai për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave. Edhe kësaj radhe vendimi nuk do të jetë në favor të Islam Krasniqi pasi komisioni vërtetoi vendimin e komisionit paraprak. Duke mos u pajtuar sërish me vendimin dhe pretendim për shkelje, z.Krasniqi paraqet ankesë pranë Keshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMK). Vendikimi i këtij të fundit do të jetë sërish i njëjtë duke konfirmuar vendimet paraprake të komisioneve. Gjykatat do të jetë adresa e radhës për të u ankuar në vendimin e KPMK-së, duke pretenduar se seanca e KPMK-së nuk kishte qenë publike dhe nuk i ishte lejuar parashtruesit të kërkesës të deponoj fakte shtesë.

Gjykata Themelore në Prishtinë refuzon kërkesën duke konstatuar se KPMK-ja nuk është e obliguar që mbledhjet e saj ti ketë publike përjashtimisht rasteve kur palët dakordohen me shkrim. Më 22 nëntor 2013 z. Islam Krasniqi do të vazhdoj ankimin e tij tani në Gjykatën e Apelit, kundër vendimit të Gjykatës Themelore duke vazhduar pretendimet se janë bërë shkelje në rastin e tij nga Ministria, komisionet përkatëse dhe gjykata themelore nuk kishte marrë parasysh provat e tij dhe kishte marrë vendim të njëanshëm. Në momentin që edhe Gjykata e Apelit hedh si të pabazë ankesën e tij, ai do të vazhdoj tutje në Gjykatën Kushtetuese. Parashtruesi i referohet gjashtë neneve të kushtetutës në të cilat pretendon se janë shkelur gjatë rastit të tij.

Sikurse potencuar më lartë në obligimet dhe detyrime e përgjegjësitë e Gjykatës Kushtetuese, parashtrimi i ankesave në këtë gjykatë duhet bërë pasi janë shterur të gjitha mundësitë tjera ligjore dhe brenda afateve të përcaktuara. Në rastin në fjalë Gjykata e hudh si të pabazuar ankesën për shkak se i njëjti nuk është ankuar edhe në gjykatën Supreme dhe se parashtrimin e ka bërë jashtë afatit kohor të paraparë sipas gjykatës Kushtetuese⁵¹.

Rasti KI13/16

Rasti i katërt të cilin do ta paraqesim këtu sërish pretendon për shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura me kushtetutë dhe me koventat ndërkombëtare. Parashktruesi i kërkesës A.S. paraqet në gjykatën kushtetuese kërkesën për vlerësim të kushtetueshmërisë së vendimit të gjykatës supreme ndaj tij. Rasti kishte filluar kur prokurori special në vitin

⁵¹ Islam Krasniqi Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 2/2014, të 21 shkurtit 2014, Vendim për papranueshmëri, Ref RKS 856/15, 6 Nëntor 2015, Prishtinë

2010 kishte filluar hetimin ndaj A.S dhe disa bashkëpunëtorëve të tij për vepra të ndryshme penale dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare. Pas një kohe këto hetime kishin pushuar, për të rifilluar sërish në vitin 2010-të e për të vazhduar me ngritje të aktakuzës në vitin 2015-të. Me pretendimin se aktakuza ishte ngritur pas afatit kohor, avokati i palës mbrojtëse kundërshton vendimin e prokurorit special. Gjykata themelore pranon ankesën e palës mbrojtëse duke kundërshtuar vendimin e prokurorit special. Megjithatë prokurori special ankesën e tij ndaj vendimit e kishte vazhduar te Gjykata e Apelit duke pretenduar se nuk ekziston ndonjë afat ligjor për ngritje të aktakuzës.

Gjykata e Apelit, vërteton vendimin e gjykatës themelore dhe i jep të drejtë palës mbrojtëse. Në shtator të vitit 2015 prokurori special parashtroi ankesë edhe në gjykatën Supreme për të shpallur të pavlefshëm vendimin e gjykatës së apelit. Me këtë rast gjykata supreme i jep të drejtë prokurorit duke e konsideruar si jo të drejtë interpretimin e gjykatave dhe konsideron se nuk ka afat për ngritjen e aktakuzës. Në drejtim të gjykatës kushtetuese parashtroesi pretendon se me këtë rast i janë shkelur të drejtat e njeriut dhe se gjykata supreme nuk ka bërë interpretim të drejtë të ligjeve.

Megjithatë Gjykata kushtetuese do ta deklarojë të papranueshme kërkesën për shkak se interpretimi i ligjeve është ekskluzivisht e drejtë dhe kompetence e gjykatave dhe nuk i takon gjykatës kushtetuese ti kontestoj ato, derisa nuk vërteton se ka shkelje të të drejtave të njeriut dhe se konstaton se pala ankuese nuk është pajtuar me vendimet e gjykatave por nuk ka paraqitur ndonjë bazë se i janë shkelur të drejtat e njeriut⁵².

Rasti KI130/16

Kryetari i Gjykatës themelore në Prishtinë, z.Hamdi Ibrahim, në Qershor të vitit 2015-të ishte ftuar për një intervistë në emisionin PULS në Kohavision⁵³. Në këtë emision z.Ibrahimi komentoi edhe punën e Prokurorisë së shtetit. Duke pretenduar se kishte tejkaluar kompetencat e tij dhe se kishte bërë sjellje të pahijshme, zyra e Prokurorit të shtetit paraqet ankesë ndaj z. Ibrahim në komisionin disiplinor pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni disiplinor merr vendimin për qortim të kryetarit të gjykatës themelore

⁵² Armend Selimi Vleresim i kushtetutshmerise se Aktvendimit te Gjykates Supreme te Kosoves, PN-II-. nr. 8/2015, te 26 nentorit 2015, Aktvendim për papranueshmëri, Ref.RK1003/16, 14 Nëntor 2016, Prishtinë.

⁵³ Emisioni Puls KTV, Mefail Bajqinovci, <https://www.youtube.com/watch?v=UuyGwAYn95s>, Prishtinë 2015, qasur më 07/12/2018

meqë pretendon se ai në intervistë kishte tejkaluar kompetencat e tij të cilat i parasheh Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Duke mos u pajtuar me vendimin në fjalë z. Ibrahim i do të parashtroj ankesë në drejtim të KGJK-së. Megjithatë ky institucion vendos të refuzoj ankesën, duke e mbështetur vendimin e komisionit disiplinor.

Pas këtij vendimi z.Ibrahimi i drejtohet gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se në rastin e tij kemi shkelje të lirisë së shprehjes. Ai konsideron se deklaratimet e tij skishin për qëllim në asnjë mënyrë dëmtimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit e as denigrimin e punës së këtij institucioni por deklaratimet e tij ishin për të mirën e institucionit dhe duhej të shiheshin si mundësi e përmirësimit të institucionit. Gjykata do të hudh poshtë kërkesën si të papranueshme meqë nuk janë shterur të gjitha mundësitë ligjore. Parashtruesi, menjëherë i është drejtuar gjykatës kushtetuese, duke pretenduar se meqë ka një post të lartë dhe me të drejta e përgjegjësi të caktuara nuk ka nevojë për shterje të mundësive të tjera por kjo nuk është pranuar si e tillë nga gjykata⁵⁴.

Rasti KI116/17

Në këtë rast parashtrues i kërkesës është Ahmet Ajeti, i cili kërkon vlerësimin e kushtetueshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 213/2017, të datës 29 Gusht 2017. Ajeti pretendon se i janë shkelur disa të drejta të garantuara me kushtetutë por edhe dispozita të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut si dhe Paktit Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike. Z. Ajeti ishte i dënuar në mungesë në Shqipëri për vrasje me paramendim me 21 vjet burgim. Ndërkohë pas shpalljes në kërkim ndërkombëtar, parashtruesi ishte arrestuar në Kosovë dhe i ishte caktuar paraburgim në kohëzgjatje prej katërdhjetë ditësh nga gjykatësi i gjykatës themelore. Ishte pikërisht ky vendim për të cilën pastaj z.Ajeti do të ankohej edhe në dy shkallët tjera: atë të apelit dhe të gjykatës supreme.

Gjykata këto të cilat do refuzonin kërkesën e parashtruesit dhe duke vendosur në favor të vendimit të parë. Për të vlerësuar kushtetueshmërinë e këtyre vendimeve dhe duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat ai paraqitet në gjykatën kushtetuese. Gjykata konstaton se kërkesa nuk ka ndonjë bazë dhe argumentim se i janë shkelur të drejtat në

⁵⁴ Hamdi Ibrahim i Vlerësim i kushtetutshmerise se Vendimit te Keshillit Gjyqesor te Kosoves, KGJK/nr. 74/2016, te 6 korrikut 2016, Aktvendim për papranueshmëri, Ref: RK 1093/17, Qershor 2017, Prishtinë

këto vendime, gjithashtu konsideron se Gjykata kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk i vlerëson vendimet e marra por vetëm aspektet administrative apo shkeljet e skajshme. Për këto arsye vendos të deklaroj kërkesën e papranueshme⁵⁵.

Zhvillimet e fundit dhe raporte të ndryshme vendore

Gjatë këtij kapitulli do të trajtohen raporte të ndryshme vendore për lirinë e shprehjes dhe atë të mediave. Raportet do të jenë nga institucionet vendore, publike, monitorimi i shoqërisë civile dhe raportet nga mediet e ndryshme relevante. Shtesë, disa nga zhvillimet e fundit në Kosovë sa i përket lirisë së shprehjes do të prezantohen më poshtë.

Qytetarët besojnë se mediat gëzojnë lirinë e shprehjes, mediat si krijues të opinionëve

Pulsi Publik është një hulumtim i cili zhvillohet çdo vit dhe lidhet me perceptimet e qytetarëve për tema me rëndësi shoqërore. Në kuadër të komponentës së Treguesit të Demokratizimit janë dy pyetje të cilat janë relevante për punimin: a) A gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes? b) A janë Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?. Të dy këto pyetje janë më së larti të ranguara pozitivisht krahasuar edhe me shtatë pyetjet e tjera në kuadër të kësaj komponente.

Në pyetjen e parë se a gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes, në Prill të vitit 2018-të 52.8% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht (Po kryesisht dhe po plotësisht), derisa në pyetjen e dytë se A janë Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?, në po të njejtën kohë, 53.4% e qytetarëve janë përgjigjur pozitivisht. Njëherit kjo është edhe përgjigja më pozitive në raport. Nëse e analizojmë trendin gjatë viteve të këtyre dy pyetjeve, në pyetjen e parë vlera më e ultë ka qenë në muajin Prill të vitit 2013-të, ku vetëm 24.6% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, respektivisht 24.2% për pyetjen e dytë në muajin nëntor të vitit 2014-të.

⁵⁵ Ahmet Ajeti Vleresim i kushtetutshmerise se Aktgjykimit te Gjykates Supreme te Kosoves, Pml. nr. 213/2017, te 29 gushtit 2017, Aktvendim për papranueshmëri, Ref: RK 1219/18, Gjykata Kushtetuese, 18 Prill 2018, Prishtinë

Avokati i popullit

I trajtuar edhe më lartë si një institucion i pavarur dhe mjaft i rëndësishëm i cili ka për synim mbrojtjen dhe lirinë e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit përveç raporteve vjetore përmbledhëse për punën dhe gjendjen e të drejtave të njeriut trajton edhe raporte ex-officio për çështje të caktuara. Gjatë vitit 2017-të ky institucion ka publikuar edhe një raport të tillë për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve. Ky raport thuhet të jetë nxitur kryesisht nga sulmet ndaj gazetarëve që kanë ndodhur gjatë vitit 2017-të. Në këtë raport liria e shprehjes identifikohet me atë të mediave dhe rrjedhimisht si e tillë edhe analizohet e tërë problematika.

Avokati i popullit në raport vlerëson se liria e shprehjes konsiderohet si një ndër vlerat kryesore të një shoqërie demokratike dhe mbrojtja dhe respektimi i kësaj të drejte është obligim edhe i institucioneve në Republikën e Kosovës. Legjislacioni aktual në fuqi, gjithmonë sipas raportit, konsiderohet të jetë mjaft i gjërë, andaj specifikisht për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e gazetarëve duhet të avansohet korniza ligjore. Shtesë, siguria e gazetarëve vlerësohet si një parakusht mjaft i rëndësishëm ku e drejta e lirisë së shprehjes mund të avansohet dhe shfrytëzohet si duhet, meqë mediat konsiderohen si mjet i rëndësishëm për të shprehur mendimet por edhe raportuar drejtë. Në këtë pikë raporti avokati i popullit shpreh shqetësimet për sulmet e gazetarëve dhe sigurinë e gazetarëve në përgjithësi⁵⁶. Konsideroj se raporti i avokatit të popullit në këtë temë është mjaft i çmueshëm edhe për hulumtimin meqë liria e shprehjes identifikohet me konceptin e lirisë së medias që është në linjë edhe me trajtimin që i bëhet në këtë studim.

Ushtrimi i profesionit të gazetarisë

Instituti për politika zhvillimore (INDEP) në vitin 2015-të ka publikuar një raport në lidhje me lirinë e shprehjes dhe ushtrimin e profesionit të gazetarisë në Kosovë, ku analizon kornizën ligjore në Kosovë dhe në rajon në lidhje me temën në fjalë. Ky studim do të jetë i vlefshëm edhe në pjesën e kapitullit ku trajtohen vendet e rajonit. Ashtu siç përmendet edhe në kapitujt e mësipërm për pjesën e lirisë së shprehjes, kuadri ligjor në Kosovë edhe për ushtrimin e profesionit të gazetarisë konsiderohet si i përshtatshëm, megjithatë

⁵⁶ Avokati i Popullit – Ex officio rasti nr. 707/2017 Raport me Rekomandime i Avokatit të popullit të Republikës së Kosovës në lidhje me Lirinë e shprehjes (medie) dhe sigurinë e gazetarëve – Prishtinë 2017

rrethanat e jashtme apo edhe zbatimi praktik është ai që ndikon për të kuptuar situatën reale.

Profesioni i gazetarisë në Kosovë mund të ushtrohet lirshëm nga kushdo, nuk ka ndonjë kufizim ligjor i cili i ndalon ndonjë personi fizik marrjen me këtë veprimtari. Gazetarë lirshëm mund ti mbrojnë burimet e tyre, përjashtim të ndonjë kërkesë nga gjykatat. Shtesë, pozitive konsiderohet edhe ekzistimi i mekanizmave vetrregullues dhe të pavarur të cilët punojnë për krijimin e një ambienti të favorshëm për ushtrimin e profesionit të gazetarisë⁵⁷.

Emisioni Drejtësia në Kosovë

Me qëllim të ngritjes së vetdijës dhe nxitjes së debatit publik, nxitur nga rastet e sulmeve të vitit 2017-të ndaj gazetarëve, emisioni Drejtësia në Kosovë, prodhim i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investiguese, në fund të vitit 2017-të realizon emision televiziv për sigurinë e gazetarëve në Kosovë. Me një shikueshmëri të lartë dhe transmetuar në televizionin publik të Kosovës, besohet se emisioni ka një ndikim të theksuar në opinionin e gjerë. Emisioni fokusohet në sulmet ndaj gazetarëve dhe vështirësitë e ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë. Në emision shqetësues paraqitet numri i madh i sulmeve ndaj gazetarëve dhe moszgjidhja e këtyre rasteve nga autoritetet kompetente⁵⁸.

Hapësira publike, si mundësi për liri të shprehjes

Trajtimin e problematikës së lirisë së shprehjes nga një kontekst tjetër, ndërlidhjen e qeverisjes me lirinë e shprehjes, konkretisht duke i trajtuar “hapësirat publike” si mundësi për liri të shprehjes, e ka paraqitur organizata joqeveritare Youth Initiative For Human Rights (YIHR) në raportin e tyre të vitit 2010-të⁵⁹. Shërbimi publik shihet si një shtyllë e rëndësishme e shtetit dhe një hapësirë ku liria e shprehjes dhe e opinionit nuk duhet të cenohet. Megjithatë, nga partitë politike në pushtet institucionet publike shfrytëzohen si mundësi për punësim të militantëve partiak, atëherë supozohet se cenimi i lirisë së shprehjes dhe opinionit është evident. Nuk pritet që ndonjë person i punësuar nga politika

⁵⁷ Ejupi, Burim Liria e shprehjes dhe ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë: analizë krahasimore e kornizës ligjore / Burim Ejupi, Dardan Abazi – Prishtinë: Instituti për Politika Zhvillimore INDEP, 2015

⁵⁸ Siguria e gazetarëve - Drejtësia në Kosovë, Kreshnik Gashi, Prishtinë 2018, qasur më 06/06/2018 <https://www.youtube.com/watch?v=G-smbD9E8wg>

⁵⁹ Youth Initiative For Human Rights, Tkurrja e hapësirës publike – Qeverisja dhe Liria e Shprehjes në Kosovë, Prishtinë 24 Maj 2010.

në administrate të mundet pastaj lirshëm të shpreh kundërshtitë, pakënaqësitë apo edhe keqpërdorimet në institucion.

Administrata shtetërore është punëdhënësi më i madh në Kosovë dhe numri i të punësuarve ka shkuar vetëm duke u rritur gjatë viteve⁶⁰. Gjithashtu, sektori privat është i ngulfatur dhe po ballafaqohet me problem për shkak të ndikimit të politikës. Shumë kompani private, biznese, financohen nga qeveria përmes kontratave të ndryshme të shërbimeve apo edhe tender. Andaj edhe kundërshtimi dhe fjala e lire e këtyre personave “juridik” është e ndaluar madje ato mund të përballen edhe me kërkesa për keqpërdorime dhe të jenë pjesëmarrës në keqbërje.

Mungesa e ligjit specifik që trajton lirinë e shprehjes

Liria e mediave konsiderohet si një e drejtë fundamentale dhe shumë e rëndësishme edhe nga Këshilli i Europës. Me qëllim të matjes standarde të lirisë së mediave në shtetet anëtare, në vitin 2008-të, Këshilli i Europës propozon “Indikatorët për Media në Demokraci”.⁶¹ Ky dokument përmban njëzeteshtatë indikatorë të cilët propozohen të analizohen nga shtetet nacionale dhe duke u bazuar në këto të analizojnë situatën e tyre aktuale në lirinë e mediave. Raportet nga shtetet anëtare duhet të mbështetën pikërisht në keta indikatorë.⁶²

Në kuadër të projektit të financuar nga Civil Rights Defender CDF, organizatat e shoqërisë civile Kosovo 2.0, Çohu dhe KMSHK kanë realizuar hulumtimin i cili bazohet në njëzeteshtatë indikatorët e lartëpërmendur⁶³. Për qëllime të studimit janë marrë për bazë dy kapitujt e këtij hulumtimi, “Korniza ligjore dhe aplikueshmëria në Kosovë” dhe “Siguria e gazetarëve”. Mostra e këtij hulumtimi bazohet në 175 responentë, të gjithë gazetarë/medime. Shumica e responentëve (shqiptarë) janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen se a garantohet me kushtetutë të Kosovës liria e shprehjes.

Ndërkohë që shumica nga komuniteti serb në pyetjen e mësipërme është përgjigjur negativisht. Në arsyet e listuara të atyre që janë përgjigjur negativisht që mendojnë se Kushtetuta e Kosovës nuk e mbron lirinë e shprehjes mbizotëron mos zbatimi praktik nga

⁶⁰ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovë 2017 / përgatitën Isa Krasniqi...[et al.] – Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2017

⁶¹ Report Doc 11683 – Committee on Culture, Science and Education, Mr Wolfgang Wodarg, Germany 2008

⁶² Resolution 1636 (2008) Indicators for media in Democracy – Parliamentary Assembly, 2008

⁶³ Media Indicators 2015 – A thorough study from a journalists’ point of view on Kosovo’s media freedom and conditions, Cohu, Kosovo 2.0, KMSHK - 2015

institucionet kompetente dhe legjislacioni i pakompletuar. Shtesë, numër i konsiderueshëm i të anketuarve mendojnë se ka mungesë të legjislacionit specifik që trajton direkt lirinë e shprehjes dhe të informacionit. Sa i përket sigurisë së gazetarëve, pjesë e trajtuar edhe në studim, shumica e gazetarëve mendojnë se janë të rezikuar nga sulmet fizike gjatë punës së tyre ditore.

Megjithatë, pune e policisë vlerësohet pozitivisht në ofrimin e sigurisë në rastet kur gazetarët kërkojnë ndihmë, derisa vlerësimi është aty-aty për institucionet e gjyqësisë në lidhje me trajtimin e rasteve të gazetarëve (fer dhe shpejtë).

E drejta e qasje në dokumente publike vlerësohet pozitivisht

Qasja në dokumente publike është një e drejtë thelbësore e cila i kontribuon përveç të tjerave në respektim dhe zbatim të lirisë së shprehjes dhe atë të medias. Në Kosovë qasja në dokumente publike është e mbrojtur dhe e garantuar me kushtetutën e Kosovës⁶⁴. Secili person ka të drejtë qasjeje në dokumente e hartuara nga autoritetet publike pa asnjë lloj të diskriminimit, përveç rasteve kur informacionet janë të mbrojtura me ligj. Gjithashtu kjo e drejtë është e rregulluar edhe me ligj të veçantë⁶⁵.

Zyra e kryeministrit çdo vit publikon raportin përmbledhës për kërkesat drejtuar institucioneve publike për qasje në dokumente publike. Gjithmonë sipas statistikave të qeverisë, numri i kërkesave ndër vite është rritur ndjeshëm si dhe përgjigjja e institucioneve është mjaft e lartë. Megjithatë ky raport duhet të merret me rezerva meqë është publikuar nga qeveria e Kosovës dhe nuk ka ndonjë reference të saktë të informatave të paraqitura. Megjithatë mund të thuhet se baza ligjore është aty dhe mjaft e avansuar e cila obligon institucionet publike që dokumentet e tyre të jenë të qasshme për publikun dhe numri i kërkesave është në rritje.

Në vitin 2010-të Lëvizja Fol kishte bërë kërkesë nga Ministria e Infrastrukturës që të ketë qasje në kontratën për ndërtimin e autostradës Morinë-Merdare. Atë kohë Ministria kishte refuzuar kërkesën e Lëvizjes Fol. Me këtë rast Lëvizja Fol kishte paditur Ministrinë e Infrastrukturës dhe pas tetë vitesh, Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar se rasti është

⁶⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës – Neni 4, http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_Kosoves-2.pdf, qasur më 14/03/2019

⁶⁵ Ligji Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>, qasur më 16/03/2019

fituar dhe që Ministria detyrohet që të lejoj qasjen e Lëvisjes FOL në dosjen e tenderit. Përkundër vonesës shumë të madhe në shqyrtim të lëndës, fitimi i rastit nga Lëvizja fol është lajm i mirë në respektim të ligjit dhe transparencën sa më të madhe të institucioneve⁶⁶. Ndërkohë, pas marrjes së aktvendimit nga gjykata themelore, Ministria e Infrastrukturës ka bërë ankesë kundër vendimit të kësaj gjykate, në gjykatën e apelit. Kjo ankesë do të zvaris edhe më shumë procesin e publikimit të kontratës.⁶⁷

Sa i përket nivelit lokal, në Komunën e Prizrenit zakonisht kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe publike bëhen nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Një e tillë, organizata Emancipimi Civil më Ndryshe si një nga kërkuesit më të mëdhenj të qasjeve në dokumente zyrtare, shpreh shqetësimet në lidhje me performancën e komunës për respektim të ligjit në fjalë⁶⁸. Komuna ka në strukturën e vet organizative edhe personin i cili është i ngarkuar për pranim dhe procesim të kërkesave nga palët e jashtme. Megjithatë përgjigjet në kërkesa zakonisht bëhen ditën e fundit ose një ditë para se të kaloj afati ligjor. Në raste më të ndjeshme financiare kur komuna nuk dëshiron të përgjigjet pozitivisht për kërkesa atëherë ajo arsyetohet se ato të dhëna janë të mbrojtura ose se kërkesa nga organizatat e shoqërisë civile apo mediet kanë qenë të paqarta.

Ligji për sinjalizuesit konsiderohet hap pozitiv

Termi i sinjalizuesve konsiderohet mjaft i ri për shoqërinë e Kosovës, ka disa vite të fundit që ka filluar të përdoret dhe të jetë aktual. Megjithatë, bota e civilizuar për aktivitetet e sinjalizuesve dhe sinjalizuesit ka kohë të gjatë që ka dëgjuar dhe punon në drejtim të mbrojtjes së tyre. Sinjalizuesit në gjuhën angleze njihen si “whistleblower”, ky term konsiderohet bukur i vonshëm⁶⁹ derisa më pare këta persona janë njohur me emra të tjerë. Por për ti dhënë konotacion pozitiv punës së tyre nga vitet e 70-ta fillon të përdoret emri “whistleblower” që në përkthimet e ndryshme lidhet me alarmin, fishkëllimën dhe vëmendjen që synohet të arrihet përmes informatës apo lajmit.

⁶⁶ FOL fiton rastin ndaj MTPT në qasjen e kontratës së autostradës Morinë- Merdare, e qasshme më 07/06/2018 <http://levizjafol.org/fol-fiton-rastin-ndaj-mtpt-ne-qasjen-e-kontrates-se-autostrades-morine-merdare/>

⁶⁷ Reagim: Qeveria e Kosovës nuk është e gatshme të publikoj kontratën e autostradës Morinë-Merdare, qasur më 07/06/2018

⁶⁸ Analizë e shkurtë, Transparenca e Qeverisjes Lokale në Prizren, Emancipi Civil ma Ndryshe, Prizren, 2012.

⁶⁹ Nader, Petkas, and Blackwell, Whistleblowing (1972).

Në gjuhën shqipe ky term është përkthyer si sinjalizues dhe spjegon personat të cilët paraqesin informata që lidhen me shkelje të ndryshme apo aktivitete joligjore në vendet e tyre të punës qoftë ato private ose publike⁷⁰. Këta sinjalizues këto informata mund ti paraqesin qoftë brenda institucioneve të tyre, jashtë institucionit apo edhe ti bëjnë tërësisht publike të dhënat. Lidhshmëria e këtij fenomeni dhe rëndësia me lirinë e shprehjes ka të bëjë me atë se kërkohet që të ju garantohet të gjithëve liria e shprehjes edhe në punë në mënyrë që flasin lirshëm, të ngrisin shqetësimet e tyre dhe mos të përballen me pasoja eventuale.

Sinjalizuesit janë mjaft të rëndësishëm sepse mund të luftojnë korupcionin, keqpërdorimet e ndryshme sidomos në sektorin publik dhe të kontribuojnë në performancën e përgjithshme të institucioneve të tyre. Meqë puna e tyre vlerësohet si mjaft e rëndësishme atëherë duhet të sigurohet edhe mbrojtja ligjore ndaj tyre në mënyrë që mos të kenë pasoja eventuale pas shpalosjes së informatave nga ana e tyre.

Shtetet Europiane, kryesisht ato të Bashkimit European e kanë të rregulluar në një formë ose tjetrën mbrojtjen e sinjalizuesve. Shumica prej tyre në mënyrë të moderuar dhe jo shumë avancuar, megjithatë të gjitha shtetet e trajtojnë këtë temë⁷¹. Kjo e fundit por ndoshta edhe rëndësia e madhe që kanë sinjalizuesit ka shtyrë së fundi edhe Komisionin European që të propozoj standarde të reja të mbrojtjes së sinjalizuesve të cilët do të raportojnë shkelje të ligjit të Bashkimit European⁷². Mbetet të shihet procedurat e ardhshme të miratimit dhe nëse do të respektohen e aprovohen këto rekomandime përfundimisht.

Ndërkohë kemi disa vendime nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e cila ju jep të drejtë sinjalizuesve të cilët në shtetet e tyre respektive kanë denoncuar raste të shkeljeve të ndryshme nga punëdhënësit ndërkohë që janë dënuar nga gjykatat kombëtare ose janë degraduar dhe ndëshkuar nga punëdhënësi. Rasti i mësuesit nga Ukraina, i njohur si rasti Marchenko v. Ukraine, është ndër më të rëndësishmit në këtë sferë. I punësuar si një mësues në shkollë dhe udhëheqës i sindikatës ai kishte akuzuar drejtorin e shkollës për keqpërdorime të ndryshme financiare. Përkundër disa tentativave të z.Marchenko për të dëshmuar keqpërdorimet dhe thirrjet që ju kishte bërë autoriteteve për hetime, ai do të dënohet nga një padi penale, e ngritur nga drejtori i shkollës për akuza të rreme. Ai do të

⁷⁰ <https://economictimes.indiatimes.com/definition/whistleblower>

⁷¹ Mark Worth, Whistleblowing in Europe, Legal protections for whistleblowers in the EU, Transparency International, 2013, Berlin, Germany

⁷² European Commission – Press Release, Whistleblower protection: Commission sets new, EU – wide rules, Brussels, 23 April 2018, qasur në http://europa.eu/rapid/press-release_IP-18-3441_en.htm

suspendohet një vit nga puna e tij. Megjithatë GjND-ja do të konsideronte se ka shkelje të nenit 10-të të lirisë së shprehjes dhe se autoritetet e Ukrainës kishin vepruar në kundërshtim me konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut⁷³.

Në rastin e Kosovës, kemi avancime pozitive. Në vitin 2018-të Kuvendi i Kosovës do të votoj njërin ndër ligjet i cili po konsiderohet si ndër më të mirit në Europë sa i përket sinjalizuesve⁷⁴. Nëse e analizojmë ligjin në tërësi, shohim se ai është i organizuar në pesë kapituj dhe në 32 nene. Ligji si i tillë rregullon të drejtat e sinjalizuesve, mbrojtjen e sinjalizuesve, mënyrat e raportimit, procedurat e ndryshme gjyqësore dhe obligimet e kompanive publike dhe private në raport me mbrojtjen e sinjalizuesve⁷⁵. Sinjalizuesi, gjithmonë sipas ligjit, ka të drejtë që të mbroj identitetin e tij, burimin e informatave nga i ka marr dhe gjithashtu edhe mbrojtjen gjyqësore. Sa i përket llojeve të sinjalizimit ato mund të jenë: të brendshme, të jashtme dhe publike. Ndërkohë punëdhënësit publik dhe ata privat obligohen që pas një numri të caktuar të punëtorëve të caktojnë edhe zyrtarin përgjegjës për sinjalizim.

Pikërisht nga mungesa e këtij ligji do të pësonte në vitin 2015 edhe z.Abdulla Thaçi, i cili kishte humbur vendin e tij të punës dhe është dënuar nga Gjykata Themelore në Prizren me gjobë prej 5,000 euro për mos respektim të konfidencialitetit dhe zbulim të informacioneve bankare⁷⁶. Z. Thaçi duke pasur qasje në llogari bankare të klientëve, si punëtor në bankën ProCredit Bank, dega në Prizren kishte vërejtur transaksione të dyshimta në llogaritë bankare të z.Nexhat Çoçajt, drejtor i Arsimit në Prizren dhe Bekim Thaçit, mësimdhënës, pas aktivitetit të mbajtur “Manifestimi i javës Remzi Ademaj”. Kështu i dënuari z.Thaci, kishte printuar gjendjen e llogarive bankare të dy personave të cekur më lartë dhe ju kishte drejtuar partisë opozitare, Vetëvendosje! dega në Prizren. Këta të fundit do të përdorin këto të dhëna për të akuzuar z. Nexhat Çoçaj për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Mirëpo, në mungesë të ligjit për sinjalizues, Z.Thaci kishte humbur vendin e punës

⁷³ CASE OF MARCHENKO v. UKRAINE (Application no. 4063/04), EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS, 19 February 2009, Strasbourg, qasur më 27/04/2019 <https://www.legal-tools.org/doc/7a92c6/pdf/>

⁷⁴ OP-ED, S'bunker, Flutura Kusari, Prishtinë, qasur më 27/04/2019 <https://sbunker.net/article10-bllogje-tematike/89696/sinjalizimi-lajme-te-mira-ne-kosove/>

⁷⁵ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 22 / 18 dhjetor 2018, Prishtinë, Ligji nr. 06/I -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, qasur më 27/04/2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18303>

⁷⁶ <https://kallxo.com/5-mije-euro-gjobe-per-ish-punetorin-e-procredit-bank/> , qasur më 27/04/2019

dhe ishte dënua nga gjykata. Në rast se do të ishte ligji aktual në fuqi z.Thaci nuk do të dënohej dhe do të shpëtonte nga aktakuza.

Rasti i dytë i njohur nga shoqëria e Kosovës, për sinjalizuesit është ai i z.Murat Mehmeti, i cili si shef i njësisë së hetimeve në Administratën Tatimore të Kosovës kishte raportuar për një mori shkeljesh në këtë institucion mjaft të rëndësishëm të Kosovës. Nga informatat e z.Mehmeti kishin rrjedhur një mori hetimesh dhe aktakuzash kundër personave të caktuar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Në mungesë të ligjit edhe z.Mehmeti kishte pësuar nga “sinjalizimi” i tij, ndonëse jo në nivel të z.Thaci. Ai ishte transferuar së pari nga vendi i tij të punës në një tjetër dhe gjithashtu gjatë një viti të plotë kishte pasur kërcënime, shantazhe, e presione të ndryshme. Megjithatë, publiciteti i madh që kishte marr nga mediat dhe vëmendja nga shoqëria kishte bërë që ai të mos përjashtohet nga puna e tij dhe të kthehet në pozitën e tij të mëparshme të punës pas një kohe.

Mungesa e sindikatës së gazetarëve

Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Kosovës, si organizatë e vetme e cila rreth vetës mbledh gazetarë dhe profesionistë të fushë gjatë zbatimit të një projekti rajonal ka publikuar hulumtimin “Treguesit për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve [Kosova 2017]⁷⁷. Hulumtimi është i ndarë në disa kapituj, për nevoja të punimit në këtë pjesë do ta trajtojmë vetëm pjesën e parë e treguesve e që lidhet me kornizën ligjore dhe ambientin ku veprojnë gazetarët. Edhe nga vet gazetarët, korniza ligjore e Kosovës vlerësohet si e përshtatshme dhe me standarde europiane/ndërkombëtare, megjithatë ajo që paraqitet si brengosëse është zbatimi i saj në praktikë dhe neglizhenca e institucioneve të cilat duhet të mbrojnë rendin dhe ligjin.

Në raport potencohet mungesa e një sindikate të gazetarëve ku gazetarët mund të paraqitnin rastet e sulmeve ndaj tyre, problemet e ndryshme dhe të mund të organizohen më mirë për çështjeve të avokimit në institucionet publike. Rastet e ankesave dhe të drejtave të gazetarëve paraqiten në asociacion si e vetmja adresë e tyre. Ekzistojnë vetëm sindikata e gazetarëve të transmetuesit publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) i cili është i preokupuar vetëm me të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të transmetuesit publik.

⁷⁷ <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/Treguesit-e-nivelit-te-lirise-se-mediave-dhe-sigurise-se-gazetareve-Kosova-2017-1.pdf> qasur më 26/09/2018

Gjithashtu një tjetër brengë e shprehur është edhe mungesa e licensimit të gazetarëve, meqë aktualisht nuk ka asnjë mënyrë të licensimit të tyre, por asocimi i tyre momental është i rregulluar vetëm me ligjin për lirinë e asociimit që ju garanton atyre bashkimin dhe veprimin e përbashkët.

Sulmet ndaj gazetarëve

Në disa raste gjatë punimit, nga burime të ndryshme u përmend mos zbatimi në praktikë i legjislacionit që garanton ambient të favorshëm për gazetarët për ushtrim të profesionit të tyre por edhe mungesën e sigurisë për ta. Viti 2017-të ka qenë shqetësues me sulmet ndaj gazetarëve. Gjatë vitit të kaluar në asociacionin e gazetarëve të Kosovës, janë regjistruar 24 raste të sulmeve ndaj gazetarëve, këto sulme kanë qenë nga ato verbale deri te sulmet fizike. Këto sulme kanë ndikim negative në punën e gazetarëve aktual të cilët potencialisht synojnë të trajtojnë tema kontraverze të kësaj shoqërie

Kryeredaktori i portalit insajderi.com Vehbi Kajtazi ishte sulmuar fizikisht me datën 16/10/2017 në një lokal në qendër të Prishtinës⁷⁸. Sipas raportit të policisë sulmuesi ju ka afruar z.Kajtazi në momentin që ai ka qenë duke u larguar nga lokali dhe e ka sulmuar me grusht duke i shkaktuar edhe gjakderdhje. Policia kishte arritur të identifikoj autorin i cili edhe ishte paraqitur më pas në polici. Sipas viktimës, sulmi kishte ardhur për shkak të punës së tij dhe ishte e lidhur ngushtë me disa raportime që portali i tij i kishte bërë s’fundi⁷⁹. Verdicti final i gjykatës rreth rastit, dënon të akuzuarin me katër muaj burgim me kusht⁸⁰.

Ndërkohë po vitin e kaluar është sulmuar edhe drejtori i portalit insajder, Parim Olluri, saktësisht me 16/08/2018 në prani të gruas së tij në Prishtinë. Përkundër që fotot e marra nga kamerat e sigurisë që kanë qenë rreth ngjarjes janë marrë nga policia, sulmuesit ende vazhdojnë të mbeten të lirë. Sikurse kolegu i tij Kajtazi edhe z. Olluri deklaroi se është

⁷⁸ <http://zeri.info/kronika/166724/detaje-se-si-ndodhi-sulmi-ku-u-pergjak-gazetari-vehbi-kajtazi/> qasur më 26/09/2018

⁷⁹ <https://www.gazetaexpress.com/intervista/interviste-vehbi-kajtazi-drejtesia-ta-denoje-edhe-milaim-zeken-si-urdherdhenes-te-sulmit-ndaj-meje-447752/> qasur më 26/09/2018

⁸⁰ <https://www.koha.net/kronike/57339/sulmuesi-i-kajtazit-denohet-me-kater-muaj-burgim-me-kusht/> qasur më 27/09/2018

sulmuar për shkak të shkrimeve të tij⁸¹, konkretisht për një shkrim të tij të fundit ku përmendet edhe komandanti legjendar Adem Jashari⁸².

Ndërkohë deri në korrik të vitit 2018-të janë regjistruar gjithsej trembëdhjetë raste të sulmeve ndaj gazetarëve, gjithnjë sipas raportimeve që janë bërë te Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Gjatë raportimit për një rast të përleshjes në Prishtinë, meqë rast ishin plagosur dy persona, në ambientet e QKUK-së sulmohet gazetari i mediumit T7 Valon Rashiti nga familjarët e njërit nga të plagosurit. Ndërkohë një sulm tjetër brutal gjatë vitit 2018-të ka ndodhur edhe në Mitrovicë ku është sulmuar fizikisht reporteri i portalit indekonline, Blerim Uka nga disa huligan serb me rastin e raportimit për vizitën e politikanit serb Marko Gjuriq në Veri të Mitrovicës⁸³. Përveç sulmeve fizike, janë regjistruar edhe raste të tjera të sulmeve si dëmtim të pronës apo edhe sulme verbale si rastet e gazetarëve e Shkumbin Kajtazi, Mentor Gjergjaj, Bujar Vitija, etj. Në të gjitha këto raste ka reaguar ashpër edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës duke kërkuar zbardhjen e rasteve dhe dënimin e sulmuesve.

Nga kërcënimet e sulmet e ndryshme nuk janë kursyer as gratë. Është Arbana Xharra, gazetare dhe ish kryeredaktore e gazetës Zëri ajo që disa here është kërcënuar dhe fyer për shkak të punës së saj si gazetare. Kishin qenë shkrimet e saj kundër “terrorizmit” dhe luftëtarëve kosovarë në Siri ato që kishin ngritur “pluhur” dhe kishin adresuar kërcënime e sharje të shumta në drejtim të Xharrës. Thënë të drejtën kjo tema e shkuarjes së kosovarëve në Siri për një kohë të gjatë ka qenë e “paprekshme” dhe është konsideruar e nxehtë për shkak se kishte të bënte me njerëz që kishin vendosur të flijohen në “emër të fesë” dhe ishin në gjendje të sakrifikonin çdo gjë nëse dikush do të shkruante kundër tyre. Gjithashtu ajo do të kërcënohej edhe kur do të publikonte disa shkrime për presidentin turk Erdogan dhe ndikimet e tij në Kosovë dhe Shqipëri. Kërcënimet e saj ndodhën kryesisht në rrjetin e saj social të facebook-ut, megjithatë në një rast ajo kërcënohet edhe publikisht në hyrje të ndërtesës së saj dhe të garazhës. Aty ishte vizatuar një kryq i madh me ngjyrë të kuqe.

⁸¹ <http://www.magazina.al/flet-parim-olluri-thote-se-shkrimi-i-fundit-per-adem-jasharin-mund-te-kete-qene-motivi-i-sulmit/> qasur më 26/09/2018

⁸² <https://insajderi.com/nese-adem-jashari-te-ishte-gjalle-dhe-te-ishte-milioner-korruptuar/> qasur më 26/09/2018

⁸³ <http://indeksonline.net/pamjet-dramatike-te-sulmit-te-huliganeve-serbe-ndaj-ekipit-te-indeksonline/> qasur më 26/09/2018

Ndërkohë liria e saj e shprehjes, konkretisht shkrimet e saj do ta privonin edhe nga udhëtimet e saj drejt shtetit turk. Sipas një postimi të Xharrës në FB ajo nuk kishte udhëtuar që nga viti 2013-të për në Turqi dhe nuk kishte shfrytëzuar as fluturimet përmes këtij shteti. Autoritetet e sigurisë së vendit tonë kishin paralajmëruar Xharrën që të mos udhëtonte dhe thuhet se edhe ambasadorja turke dhe autoritetet e shtetit turk në Kosovë e kishin lajmëruar Xharrën në Turqi për shkrimet e saj anti Erdogan dhe të shtetit turk.

Nuk është ky rasti i parë ku gazetarët përveç nga qytetarët e rëndomtë kërcënohen edhe nga autoritetet publike dhe persona me peshë dhe poste politike e publike. Është gjithashtu rasti i gazetarit, Xhemajl Rexha, nga televizioni KohaVision, KTV, i cili pasi publikon një kronikë në lidhje me politikanen Alma Lama, e emëruar ambasadore në Romë fyet nga kjo e fundit publikisht përmes rrjetit të saj social. Kronika e përgatitur nga gazetari Rexha, pasqyron vetëm fakte reale të aktiviteteve politike të znj. Lama dhe lëvizjeve që ajo kishte pasur nëpër parti. E irrituar thellë nga kjo storie e përgatitur ajo fyen gazetarin Rexha duke e quajtur pseudogazetar dhe në të njejtën kohë bën etiketime duke e konsideruar se orientimin e ka nga Beogradi.

Edhe gazetari i portalit veriu.info, gazetari Gazmend Morina ishte sulmuar nga zyrtarë publik, konkretisht nga ansambleisti i komunës së Mitrovicës dhe disa persona të tjerë për shkrimet e gazetarit Morina kundër menaxherit të Trepçës⁸⁴. Sipas gazetarit Morina, fillimisht ai ishte kërcënuar nga këta persona në një restorant, për të pasuar më pas me një sulm fizik ndaj ti në qytetin e Vushtrrisë. Ndërkohë prokuroria themelore e Mitrovicës ka ngritur aktakuzë ndaj këtyre personave por seancat gjyqësore janë shtyer për këtë rast⁸⁵.

Saranda Rama, gazetare investigative kishte raportuar një kohë për disa parregullsia dhe shkelje të cilat kishin ndodhur në raportin e parë të Kontrollit të Prokurorisë Shtetërore. Me këtë rast disa individë kishin vizituar familjen e saj dhe i kishin kërcënuar ata, duke ju lënë një kartë vizite dhe numër të telefonit, meqë rast kanë kërkuar edhe takim me gazetaren. Megjithatë, takimi me këta persona nuk kishte ndodhur kurrë, përkundër që gazetarja kishte kërkuar takim zyrtar në zyret e gazetës në të cilën punonte. Pas një kohe

⁸⁴ <https://vushtrriaonline.net/2016/01/sulmohet-gazetari-vushtrrias-gazmend-morina/>, qasur më 06/12/2018

⁸⁵ <https://zeri.info/kronika/120918/prokuroria-ngrit-aktakuze-kunder-dy-sulmuesve-te-gazetarit-gazmend-morina/>, qasur më 06/12/2018

sipas gazetares ky raport ishte larguar dhe personat të cilët kishin kërcënuar kishin pranuar fajin e tyre.

Një tjetër rast i kërcënimit serioz ka ndodhur edhe ndaj kryeredaktorit të gazetës Express, Leonard Kërquki. Në fakt do të jenë temë e madhe e diskutimit të opinionit public dokumentarët (dy pjesë) të transmetuar me titullin “Gjahu i UÇK-së”⁸⁶, dokumentar ky që flet për krimet e luftës, sërëbet e vrarë dhe dëmet që ju kishin shkaktuar këtij komuniteti gjatë viteve të luftës në Kosovë. Pas transmetimit të këtij dokumentari do të vërshonin kërcënimet dhe sharjet ndaj z.Kërquki dhe gazetës Express për këtë dokumentar duke kërkuar edhe të tërhiqet ky dokumentar, për shkak se konsiderohej se po fyente luftën e UÇK-së dhe kishte të pavërteta në të.

Një rast tjetër për të cilin prokuroria themelore kishte ngritur aktakuzë është edhe rasti ndaj Mifat Berishës, personi i cili kishte kërcënuar gazetarin e mediumit të KTV-së për një kronikë të emetuar në këtë television. Kronika e përgatitur kishte të bënte me një grua e cila kërkonte të drejtat e saj pas vdekjes së bashkëshortit. Dhe pikërisht ishte familjari i burrit ai që kishte telefonuar në redaksinë e televizionit dhe kishte kërcënuar edhe gazetarin me atë se mund të paguaj me kokë nëse do të raportonte sërish për rastin e njejtë. Me këtë rast prokuroria themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë për personin në fjalë.

Rast të ngjashëm ku kërcënim i ka ardhur nga institucionet publike dhe persona zyrtarë të cilët do të duhej të ishin shembull të respektimit të ligjit, ka përjetuar edhe gazetarja e Kohës Ditore, Edona Kërleshi. Në një shkrim në gazetën me datën 6 Nëntor, gazetarja Kërleshi raporton se bufenë e Minsitrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e furnizon me kafe pikësisht shefi i kabinetit të minsitrit dhe këshilltari i tij z.Baton Dushi. Ndërkohë ndaj këtij shkrimi ka reagur z.Dushi së pari me një shkrim në profiling e tij në FB duke treguar se pse shkrimi i gazetarës nuk ishte i vërtetë, ndërkohë me një shkrim tjetër ajo kishte fyer dhe ofenduar gazetaren ku e kishte quajtur “përbindëshe”. Për të rënduar edhe më shumë këtë rast, me këtë postim të shefit të kabinetit të ministrit, pajtohet edhe ministri me dy këshilltarët e tij duke e pëlqyer artikullin në fjalë.

Sistemi i drejtësisë dhe organet e sigurisë përballë gazetarëve

⁸⁶ Express, Gazeta. “#ZonaExpress: ‘Gjahu Në UÇK’ (Pjesa e Parë).” YouTube, YouTube, 16 Oct. 2016, www.youtube.com/watch?v=AXfdU7Nf52c.

Ashtu siç u potencua disa herë gjatë punimit, Kosova ka një kornizë ligjore bukur të avansuar sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut, lirive të shprehjes por edhe ambientit të punës për gazetarë. Megjithatë, brengosëse janë shifrat e sulmeve ndaj gazetarëve por edhe numër i ultë i rasteve të trajtuara nga prokuroria dhe policia lidhur me këto sulme. Sulmet ndaj gazetarëve dhe mos trajtimi i tyre ndikon drejtpërdrejtë në shkelje të të drejtave të njeriut por edhe cenim të demokracisë. Kosova përballlet me shumë probleme në sistemin gjyqësorë dhe shumë lëndë ende mbeten të pazgjidhura, e shumë prej tyre edhe parashkruhen pa arritur të shqyrtohen.

Deri vonë, edhe rastet e gazetarëve nuk është se janë trajtuar me prioritet por edhe nuk është treguar ndonjë gatishmëri e theksuar nga prokuroria për të trajtuar këto raste. Sipas prokurorisë nga viti 1999-2016 janë paraqitur 130 raste të sulmeve dhe kanosjeve ndaj gazetarëve. Ndërkohë policia e Kosovës nga viti 1999-2016 ka trajtuar gjithsej 154 raste në të cilat protagonistë janë gazetarët. Nga këto raste: 50 janë kanosje, 8 raste të sulmeve, 7 lëndime trupore, 10 dëmtime prone, 5 ndërhyrje në punë, 38 vjedhje të paisjeve, 36 të tjera. Megjithatë, në dy vitet e fundit ka pasur zhvillime sa i përket angazhimeve të institucioneve në lidhje me trajtimin e rasteve të gazetarëve. Janë bërë dy veprime të cilat i vlerësoj si pozitive të cilat do të ndihmojnë në krijimin e një ambienti sa më të sigurtë për gazetarët për të ushtruar profesionin e tyre, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut por edhe ngritjen e transparencës në kuadër të institucioneve të drejtësisë, konkretisht prokuroritë e Kosovës.

Pas një takimi të realizuar në mes të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi në vitin 2017-të, nga ky i fundit ishte premtuar që do të caktohet një koordinator i cili do të merret me rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Me datë 08.03.2017 Kryeprokurori i shtetit merr vendim ku z. Besim Kelmendi emërohet koordinator për rastet e kanosjeve apo veprave të tjera penale ndaj gazetarëve në kuadër të zyrës së kryeprokurorit të shtetit⁸⁷. Shtesë, po i njejtë vendim obligon prokuroritë themelore që të emerojnë nga një prokuror që do të merret me rastet e gazetarëve, ku ata paraqiten si të dëmtuar dhe duhet ti trajtojnë këto raste me prioritet⁸⁸.

⁸⁷ Zyra e kryeprokurorit të shtetit, Vendimi nr. 271/2017, datë 09-03-2017, Prishtinë

⁸⁸ Po aty

Një tjetër lëvizje pozitive e cila është realizuar në vitin 2018-të dhe është në vi me përmirësimin e ambientit në të cilën zhvillojnë punën gazetarët por do të kontribuonte edhe në mos emetimin e lajmeve të rreme por edhe ngritjen e transparencës së prokurorive është marrë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK). Në mbledhjen e 153-të të këtij këshilli është marrë vendimi për emërimin e prokurorëve të cilët do komunikojnë me mediat për çfarëdo rasti apo interesimi në lidhje me prokuroritë e caktuara.⁸⁹

Iniciative për ligj të ri për Media dhe bashkëpunimi me prokurorinë

Në kapitujtë e mësipërm është trajtuar korniza ligjore me të cilën janë rregulluar mediat në Kosovë. Korniza ligjore e cila e rregullon lirinë e medias (informimit) në Kosovë rregullohet me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve, Ligji për KPM-në dhe ligjin për qasjen në dokumente publike. Megjithatë nuk kemi ligj të veçantë për media. Ndërkohë vlerësohet se korniza aktuale ligjore është e mjaftueshme dhe Kosova sa i përket legjislacionit është në rregull. Sfidat janë kryesisht në zbatim të legjislacionit aktual.

Ndërkohë, në mbledhjen e mbajtur me datë 8 Maj 2018, Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka miratuar Iniciativën e komisionit për plotësim ndryshimin e ligjit për KPM-në dhe për hartim e draft Ligjit të mediave në Kosovë. Kryetari i këtij komisioni, deputeti Nait Hasani, në një intervistë për televizionin Koha Vision, deklaroi ndër të tjera se “Në Kosovë, janë 250 portale e prej tyre vetëm 30 të regjistruara. Pjesa tjetër janë pjesë e portaleve që përdoren për shantazhe, për fyerje e keqpërdorime të ndryshme. Ne synojmë që t’i disiplinojmë këto portale”.

Një iniciativë e tillë ka ngjallur reagime të shumta të gazetarëve dhe personave publik të cilët e kanë konsideruar një iniciativë të tillë të ngutshme, të panevojshme dhe jo në moment të duhur. Ndërkohë mos konsultimi i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, ka ngjallur reagimin e këtyre të fundit për mos përfshirje të palëve të interesit në fazën fillestare⁹⁰. Tutje, ata shprehin shqetësimin e tyre me zbatimin e ligjeve ekzistuese dhe jo mungesën e ligjeve positive të cilat në mënyrë të drejtë dhe të rregullt rregullojnë lirinë e shprehjes dhe atë të mediave.

⁸⁹ Agjenda e takimit të 153-të të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prishtinë

⁹⁰ Reagim publik i AGK-së, www.agk-ks.org, qasur më 05/06/2018

Gjatë viteve të fundit gazetarët dhe punëtorët e mediave janë përballur me raste të ndryshme të kërcënimeve dhe sulmeve fizike për punën e tyre. Prokurorët e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve nuk është se kanë trajtuar me prioritet këto raste dhe gjyqtarët nuk kanë sjellur në seanca të akuzuarit. Shumë lëndë kanë filluar edhe të parashkruhen për shkak të vjetërsimit të lëndëve.

Për të adresuar këtë çështje, përmirësuar praktikën dhe rritjen e bashkëpunimit, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës me datë 8 Mars 2018 ka mbajtur një takim me kryeprokurorin e shtetit të Kosovës, z.Aleksandër Lumezi⁹¹. Ndër të tjera gjatë këtij takimi, kryeprokurori Lumezi njoftoi se ka hartuar vendim, i cili pritët të hyjë në fuqi së shpejti, me të cilin ka caktuar një prokuror nga Zyra e tij koordinator për rastet e kanosjeve apo veprave tjera penale që kryhen ndaj gazetarëve në lidhje me punën e tyre⁹².

Ky premtim i kryeprokurorit të shtetit është realizuar me vendimin e datës 08.03.2017 ku emërohet koordinatori për rastet e kanosjeve apo veprave tjera penale që kryhen ndaj gazetarëve në lidhje me punën e tyre. Gjithashtu vendimi parasheh edhe disa pika të tjera të cilat i obligojnë kryeprokurorët e prokurorive themelore që të caktojnë nga një prokuror, që do të merret me rastet e raportuara. Shtesë, pika e tretë e vendimit i fton prokurorët që rastet e gazetarëve të i trajtojnë me prioritet dhe ta informojnë prokurorin e ngarkuar si koordinator. Vendimi mbyllet me pikën katër e cila parasheh edhe mbajtjen e një database të posaçme në lidhje me këto raste⁹³.

Lajmet e rreme, fenomen global që ka ndikuar edhe te ne

Shumica prej përdoruesve të rrjeteve sociale, portaleve të ndryshme kanë dëgjuar që një kohë të gjatë për termin “fake news”. Megjithatë, kohët e fundit gjithnjë e më shumë ndërkombëtarisht po diskutohet në lidhje me këtë term i cili po konsiderohet edhe si cënuesi dhe dëmtuesi kryesor i demokracisë në tërësi, i lirisë së shprehjes në veçanti. Ky fenomen global kryesisht ka atakuar mediat online dhe portalet e ndryshme të cilat me anë të klikimeve të ndryshme veq të tjerave po arrijnë edhe përfitime monetare.

Edhe pse përfitimet monetare janë një anë e medaljes, pasojat më të mëdhaja konsiderohen nxitjet e ideologjive të ndryshme, lobimi i grupeve të ndryshme për interesa

⁹¹ Buletini mujor – Aktivitetet e prokurorit të shtetit Janar – Mars 2017, qasur më 05/06/2018

⁹² Ibid

⁹³ Vendimi nr. 88/2017, protokoluar nr. 271/2017, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

të caktuar duke fyer e ofenduar persona apo dukuri të caktuara pa asnjë bazë të vetme. Madje opinionistë të ndryshëm në shkrimet e tyre kanë ngjallur dyshime të mëdha se pikërisht lajmet e rreme kanë ndikuar edhe në zgjedhjen e Donald Trumpit si president i SHBA-ve. Madje edhe një studim i Universitetit të Ohaios është realizuar pikërishtë mbi këtë hipotezë⁹⁴.

Pra, siç mund të vërehet ndikimi i këtyre lajmeve të rreme ka kaluar çdo kufi dhe ka marrë përmasa shumë të mëdha. Kjo mënyrë e “raportimit” e etiketimit të lajmeve të rreme është një “det i mundësive” për njerëzit të cilët po dëshirojnë që qoftë të përfitojnë materialisht përmes klikimeve apo edhe atyre që dëshirojnë të shtyejnë interesa të caktuar. Padyshim se këto trende globale herët apo vonë po arrijnë të depërtojnë edhe në Kosovë. Nëse i referohemi numrit të madh të personave të cilët penetrojnë internetin, që sipas një studimi të vitit 2013-të të Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës është 76.6% depërtimi i internetit sipas përdoruesve atëherë mund të paramendojmë ndikimin eventual që mund të kenë lajmet e rreme. Njëkohësisht, kjo shifër me gjasë viteve të fundit është rritur edhe më shumë duke marrë për bazë ofertat shumë të lira të kompanive që ofrojnë shërbime të internetit.

Kosova ka “lulëzuar” gjithashtu vitet e fundit nga portalet e ndryshme, sipas shifrave jozyrtare diku mbi 30095 portale ekzistojnë në Kosovë që qëllim kanë informimin e qytetarëve të vendit në lidhje me zhvillimet e fundit në vend. Shumë prej portaleve nuk dihet edhe se nga kush janë themeluar dhe nuk kanë ndonjë informate se kush qëndron prapa tyre. Qytetarët nuk janë të informuar se prej kujt marrin informata dhe kredibiliteti i këtyre portaleve zakonisht është shumë i ulët.

Përfitimi financiar zakonisht nga disa nga këto portale është primare në krahasim me anën e tyre profesionale. Shumë lajme të “rreme” apo të paverifikuara paraqiten me të vetmin qëllim që të nxisin kurreshtjen e qytetarëve dhe të rrisin numrin e klikimeve. Së dyti, lexuesit potencial synohen të “joshen” përmes titujve bombastik të cilat shpeshherë edhe nuk kanë të bëjnë asgjë me përmbajtjen reale të tekstit apo edhe këto tituj lidhen me rubrikat “rozë” të cilat edhe janë mjaft atraktive për përdoruesit. Shtesë, në shumë raste

⁹⁴ <https://www.documentcloud.org/documents/4429952-Fake-News-May-Have-Contributed-to-Trump-s-2016.html> , qasur më 23 Prill 2019

⁹⁵ <https://www.eurozine.com/11258-2/> , qasur më 23 Prill 2019

lajmet vetë kopjohen nga njëri portal në tjetrin, nuk verifikohen fare, madje ato postohen edhe pa asnjë reference.

Lajmet e “rreme” shpesheherë bëhen të tilla edhe nga mungesa e profesionalizmit, jo vetëm me dashje. Ata të cilët i postojnë marrin një informatë nga ndonjë burim i caktuar apo nga vendi i ngjarjes mirëpo pa i konfirmuar fare rrethanat, pasojat apo shkaqet postojnë lajme dhe ato pastaj automatikisht mund të dalin si të “rreme” pas një kohe pasi nuk janë verifikuar të dhënat. Në botë kanë filluar edhe disa masa përmes të cilave po synohet edhe parandalimi i lajmeve të rreme apo edhe edukimi i qytetarëve se si duhet të verifikohen apo edhe të i shmangim këto lajme të rreme. Dy shembuj të trajtimit të lajmeve të rreme vijnë nga Republikën e Çekisë dhe rasti tjetër nga Republikën e Maqedonisë Veriore.

Rasti i parë përveç që është edukativ, paraqitet edhe mjaft inovativ. Fjala është për një lojë e cila është krijuar nga studentët e departamentit të shkencave politike në Universitetin e Masayk në Çeki. Kjo lojë synon që përmes angazhimit praktik të i edukoj dhe në të njëjtën kohë të i sfidoj studentët por edhe qytetarët në lidhje me “lajmet e rreme”. Me anë të kësaj loje ju bëheni gazetarë në vitin 2028-të para zgjedhjeve presidenciale në Çeki dhe duhet të arrini që të identifikoni kandidatin i cili përhap dezinformata dhe të ndaloni planin e tij për të anuluar pushimet verore. Kjo lojë quhet Fakescape⁹⁶ dhe është treguar mjaft atraktiv për periudhën sa është përdorur. Megjithatë për momentin funksionon vetëm në gjuhën çeke mirëpo pritet që në të ardhmen të lansohet edhe versioni në gjuhën angleze.

Sa i përket rastit të dytë, në Maqedoni, kemi të bëjmë me një projekt të implementuar nga një organizatë joqeveritare, fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorphosis⁹⁷. Projekti në fjalë i financuar nga USAID për qëllim ka verifikimin e fakteve të postuara nga mediumet e ndryshme, për këtë qëllim ata kanë lansuar edhe një portal www.verifikimiifakteve.mk ku postohen dhe analizohen artikuj të ndryshëm të cilat nuk verifikojnë fakte apo kanë për qëllim vetëm dezinformimin e publikut. Me anë të këtij projekti synohet edhe vetëdijësimi i qytetarëve, ku ata mund të dërgojnë lajme të caktuara për verifikim por edhe mund të lexojnë artikuj të ndryshëm. Shtesë, mediet e ndryshme por

⁹⁶ <http://fakescape.cz/en/about-us/>, qasur më 23 Prill 2019

⁹⁷ www.metamorphosis.org.mk, qasur më 23 Prill 2019

edhe gazetarët do të rrisin vigjilencën dhe profesionalizmin para se të postojnë ndonjë lajm duke ditur se dikush i “monitoron” ata.

Raportet Ndërkombëtare

Krahas raporteve vendore dhe pikëpamjeve të akterëve të ndryshëm në lidhje me temën në këtë seksion do ti bëhet analizë raporteve ndërkombëtare në lidhje me gjendjen e lirisë së shprehjes në Kosovë dhe rolit të mediave. Raportet të cilat janë trajtur më poshtë dhe marrin për bazë Kosovën në analizën e tyre janë: Departamenti i Shtetit, Freedom House, Human Rights Watch, Raporti i Progresit, Reporters Without Borders, Transparency International. Këto raporte ndërkombëtare kredibile japin edhe një perspektivë tjetër për Kosovën. Në përgjithësi, nëse i përmbledhim të gjitha raportet ato kryesisht kanë një vlerësim jo shumë pozitiv për gjendjen në Kosovë. Shqetësuese vazhdon të mbetet ndikimi i politikës në media dhe siguria e gazetarëve në përgjithësi.

Department of State – Human Rights

Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës harton raporte vjetore për të gjitha vendet të cilat janë anëtare të Kombeve të Bashkuara, apo marrin ndihmë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto raporte mbulojnë të drejtat e njeriut, duke përfshirë

të drejtat individuale, civile, politike dhe të drejtat punëtore të cilat edhe janë të njohura ndërkombëtarisht dhe përfshihen në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut⁹⁸. Raporti për Kosovën parasheh shtatë seksione dhe disa nënseksione. Për nevoja të punimit tajtohet seksioni i dytë i cili përfshin respektimin e lirisë civile, konkretisht në nënseksionin a) i cili parasheh lirinë e shprehjes dhe të mediave.

Raporti për vitin 2017-të konfirmon edhe shqetësimet e brendshme në Kosovë në lidhje me situatën në vend por edhe vlerësimet positive për legjislacionin në vend⁹⁹. Shtesë, potencohet edhe iniciativa e Ministrisë së Drejtësisë për të propozuar ndëshkimin e personave të cilët mund të shpifin apo fyejnë presidentin e vendit, propozim ky i cili o tërhoq për shkak të presioneve nga opinioni dhe shoqëria civile. Vend në këtë raport zënë edhe sulmet e gazetarëve të ndodhura gjatë viteve 2017-të, disa prej tyre të trajtuara edhe më lartë në këtë hulumtim. Në përgjithësi ky raport nuk ka ndonjë përmirësim apo ndryshim nga raporti i vitit 2016¹⁰⁰. Pra, Kosova vazhdon të mbetet një vend ku liria e shprehjes nuk respektohet mjaftueshëm dhe ushtrimi i profesionit të gazetarisë nuk është aspak i lehtë.

Freedom House

Një tjetër raport mjaft kredibil i cili është gjithashtu vjetor dhe është duke u realizuar që nga viti 2018-të është edhe raporti i përgatitur nga Freedom House. Fokusi do të jetë te raporti “Freedom of the Press” i cili realizohet për 199-të shtete të botës. Ky raport ka një metodologji specifike dhe fokusohet në analizë përmbajtësore dhe statistikore. Çdo shtet notohet edhe me pikë nga 1 deri në 100 nga i cili pikëzim vihet edhe kategorizimi si vend: i lire, gjysëm i lirë dhe jo i lirë. Vlerësimi arihet nga një pyetësor prej 23 pyetje i ndarë në tri kategori kryesore: ambienti ligjor, ambienti politik dhe ambienti ekonomik. Bazuar në këto vlerësimi, Kosova për vitin 2017-të renditet në pozitën e 82-të¹⁰¹, 8 pozita më lartë se viti 2016-të.

⁹⁸ Department of State, Bureau of Democracy, Human Rights and Labor Country Reports on Human Rights Practices for 2017

⁹⁹ Country Reports on Human Rights Practices for 2017 United States Department of State • Bureau of Democracy, Human Rights and Labor - Kosovo

¹⁰⁰ Country Reports on Human Rights Practices for 2017 United States Department of State • Bureau of Democracy, Human Rights and Labor – Kosovo 2016

¹⁰¹ Freedom House, Press Freedom’s Dark Horizon, Contry Kosovo, 2017, New York

Megjithatë edhe në këtë pozitë mbetet si vend, gjysmë i lire sa i përket lirisë së medias. Nëse shohim rankimin e vendeve të rajonit mund të shohim se Kosova qëndron më mirë se fqinjët e saj Maqedonia (111) dhe Mali i Zi (106) derisa është më keq se Serbia (66) dhe Shqipëria (76). Derisa katër vendet e para, të cilësuar si vendet me lirinë e medias më të madhe janë shtetet e skandinavisë: Norvegjia (1), Suedia (2), Finlanda (3), Danimarka (4) derisa vendet me më së paku liri të mediave janë: Turkmenistani (178), Eritrea (179) dhe Korea e Veriut (180).

Human Rights Watch

Raportimi për Kosovën në raportin e HRW-së për vitin 2017-të¹⁰² në seksionin e lirisë së mediave dhe të informacionit paraqet sulmet ndaj gazetarëve dhe reagimet e ndryshme të komunitetit të gazetarëve. Gjithashtu, përmendet edhe trajtimi i ulët i rasteve të gazetarëve nga prokuroria.

Progress Report

Bashkimi Europian çdo vit përpilon raporte në lidhje me progresin e arritur si shtet. Në raportin e publikuar në vitin 2018-të, që mbulon vitin 2017-të Bashkimi Europian vlerëson se në përgjithësi Kosova nuk i ka përmbushur ende rekomandimet e vitit 2016-të. Nëse shohim rekomandimet e vitit 2016-të, ajo parashohin trajtimin e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve, të shiqoj për sigurim të financimit të qëndrueshëm të transmetuesit publik, të siguroj masa që do të bënin më transparent informatat mbi pronësinë e mediave. Raporti konstaton se Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë mjaftueshëm sa i përket avansimit të çështjes së transmetuesit publik, RTK-së, sidomos në aspekt financiar, dhe kjo ka ndikuar në një formë që edhe presionet në drejtim të këtij institucioni të jenë evidente¹⁰³.

Reporters without borders

Reporters without borders është një organizatë joqeveritare me mjaft reputacion në nivel ndërkombëtar. Ajo bazën kryesore e ka në Paris, megjithatë shtrihet edhe në dhjetë kryeqendra botërore. Numër i madh i bashkëpunëtore dhe gazetarëve e ka bërë një

¹⁰² Human Rights Watch, Yearly Report 2018 – Country Serbia/Kosovo, New York, 2017

¹⁰³ European Commission, Kosovo* 2018 Report, 17.04.2018, Strasbourg

institucion mjaft kredibil dhe i cili mundet në çdo moment të mobilizoj njerëz apo kauza të ndryshme që lidhen me gazetarët. Kjo agjenci ndërkombëtare që nga viti 2002 përpilon edhe indeksin botërorë të lirisë së mediave ku edhe rangon shtetet. Metodologjia e këtij raporti konsiston në një pyetësor me 87-të pyetje që ju drejtohet ekspertëve dhe njohësve të çështjeve në 180-të vende të botës si dhe analizë të sigurisë së gazetarëve në vendet respective. Janë gjithsej shtatë kategori në pyetësor dhe pastaj bëhet edhe llogaritja e pikëve sipas një sistemi të formulave dhe indikatorëve.

Në raportin e fundit të vitit 2018-të të RWB-së Kosova rangohet si e 78-ta në ranglistën e 180-të shteteve. Krahasuar me vitin 2017-të ka një përmirësim prej katër vendeve. Pikët totale janë 30.45 të cilat e kategorizojnë si vend problematik, sepse nga 25.01 deri më 35 pikë vendet konsiderohen si problematike dhe ngjyra e tyre është e portokalltë. Duhet theksuar se nuk është larg edhe kategorisë që është e parafundit, e cila quhet “keq” e që është nga 35 pikë e tutje, pra vetëm 4.45 pikë është larg, edhe pse trendet e fundit janë drejt përmirësimit dhe jo e kundërta. Krahasuar me vendet e rajonit, Kosova qëndron më mirë se Maqedonia dhe Mali i Zi dhe më keq se Serbia dhe Shqipëria¹⁰⁴.

Transparency International

Transparency International është organizatë joqeveritare e cila shtrihet në më shumë se 100 shtete, ndërsa udhëhiqet nga një sekretariat i vendosur në Berlin. Misioni i kësaj organizate është të luftoj korrupsionin. Në vitin 1995 publikohet për herë të parë edhe indeksi i perceptimit të korrupsionit. Edhe ky indeks sikurse të rasti i reporterevë pa kufij rangon shtetet nga ato me korrupsionin më të ulët deri te ato me nivel të lartë të korrupsionit. Sa më shumë pike aq më pak i korruptuar cilësohet vendi. Kosova në vitin 2017-të radhitet në vendin e 85-të me gjithsej 39 pikë. Në përmbledhjen për Kosovën në raportin e TI-së thuhet se legjislacioni në vend garanton shprehje të lirë, megjithatë zëri i shoqërisë civile dhe mediave dëgjohej shumë pak.

¹⁰⁴ Reporters Without Borders, Annual Report 2018, Country Kosovo, Paris

Vendet e rajonit

Për të pasur një bazë krahasuese me atë se ku qëndron Kosova në raport me vendet e rajonit do të i bëjmë një analizë në terma të përgjithshëm edhe vendeve të rajonit me atë se ku qëndrojnë këto vende në respektim të të drejtave të njeriut, konkretisht lirisë së shprehjes dhe si qëndrojnë në raportet ndërkombëtare. Janë trajtuar Shqipëria dhe Maqedonia, dy vende me të cilat kufizohet Kosova dhe të cilat afërsisht janë në pozita të njëjta edhe si Kosova. Ndërkohë, është analizuar edhe shteti i Turqisë i cili është i rënditur mjaft poshtë në raportet ndërkombëtare. Përkundër këtyre vendeve mëposhtë edhe Suedia është analizuar si njëri ndër vendet me lirinë e shprehjes më të avancuar në botë .

Shqipëria

Ashtu sikurse në rastin e Kosovës edhe në Shqipëri, mbrojtja e lirisë së shprehjes është kategori kushtetuese. Pjesa e dytë e kushtetutës flet për të drejtat dhe liritë e njeriut ndërsa specifikisht, neni 22 flet për lirinë e shprehjes, derisa neni 23 i kushtetutës garanton

të drejtën e informimit¹⁰⁵. Ndërkohë që kjo e drejtë rregullohet edhe me ligje të tjera në fuqi si: ligji për informim nga dokumentet zyrtare, ligji për mediat audiovizuale, kodi i procedurave administrative. Ndërsa për dallim nga Kosova e cila ka kufizim në të drejtën e informacionit, Republika e Shqipërisë nuk parasheh asnjë kufizim të lirisë së shprehjes¹⁰⁶.

Sa i përket raporteve ndërkombëtare, në raportin e Freedom House, për lirinë e mediave, Shqipëria shënon 68 nga 100 pikë dhe ka statusin si vend gjysmë i lirë. Në përmbledhjen e raportit theksohet se Shqipëria vazhdon të përballet me shkallë të lartë të korrupsionit dhe krim të organizuar. Derisa, liria e shprehjes dhe e mediave vlerësohet se mbrohet me kushtetutë dhe ligjet në vend, megjithatë, në termet praktikë ka problem sidomos të kontrollit të mediave dhe monopolist që ushtrojnë dy partitë më të mëdha në vend PD dhe PS.

Njëra ndër vendet e cila do të ketë përkeqësim në ranglistë në raporte ndërkombëtare do të jetë Shqipëria dhe atë në raportin e RWB-së, sa i përket indeksit për lirinë e mediave. Nga pozita e 75-të në vitin 2017-të do të renditen në vendin e 82-të në vitin 2018¹⁰⁷. Raporti do të përmend ndikimin e politikës në media dhe financimin e tyre të dyshimtë derisa kritikohet edhe qeveria aktuale e sidomos z.Rama i cili shpeshherë në publik ka ditur të i fyej dhe etiketoj mediat si servil të partive politike. Gjithashtu duke i akuzuar ata si joprofesionistë dhe shpërndarës të lajmeve të rreme.

Maqedonia

Republika e Maqedonisë lirinë e shprehjes e garanton me kushtetutën e saj. Konkretisht, neni 16-të i kësaj kushtetute garanton edhe lirinë e shprehjes publike të mendimit. Ndërkohë Liria e Medias është e rregulluar me ligjin për media dhe ligjin për mediat audiovizuale. Sipas një analize krahasuese nga organizata joqeveritare INDEP nga Prishtina në lidhje me ushtrimin e funksionit të profesionit të gazetarisë në Kosovë dhe

¹⁰⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, qasur më 22/11/2018 në <http://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/sq/al/al057sq.pdf>

¹⁰⁶ Liria e shprehjes dhe ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë : analizë krahasimore e kornizës ligjore / Burim Ejupi, Dardan Abazi. – Prishtinë : Instituti për Politika Zhvillimore INDEP, 2015. – 21 cm.

¹⁰⁷ Reporters without borders, Freedom of the Press Index, Country Albania, <https://rsf.org/en/albania>, qasur më 30/04/2019

rajon, Maqedonia paraqitet si ndër vendet e rralla në rajon ku liria e shprehjes nuk kufizohet nga kushtetuta¹⁰⁸.

Gjithashtu, sipas po të njejtit hulumtim në Maqedoni shpifja nuk paraqet vepër penale. Sipas raportit të Freedom House të vitit 2018-të, Maqedonia paraqitet si vend pjesërisht i lirë duke marrë në total 58-të nga 100 pikë¹⁰⁹. Përmbledhja e këtij raporti shpreh shqetësimin për nivelin e lartë të korupsionit në Maqedoni, vlerëson aktivitetin e gazetarëve dhe shoqërisë civile mirëpo nënvizon vështirësitë e mëdha dhe sfidat që kalojnë këto dy kategori.

Për katërmbëdhjetë pozita do të ngjitet Republika e Maqedonisë në raportin e fundit të organizatës Reporters without borders, nga vendi i 109-të në atë të 95-të. Ndryshimi i qeverisë në republikën e Maqedonisë ka sjell një lloj shprese dhe përparimi në disa sektorë të qeverisjes. Siguria e gazetarëve vlerësohet më e mirë, statistikave tregojnë se afësisht as 1/3-ta e sulmeve të ndodhura nga viti paraprak nuk kanë ndodhur në vitin e fundit. Megjithatë, shqetësimet vazhdojnë në anën e kornizës ligjore ku përmendën ndryshim plotësimet që mund të bëhen në Ligjin për qasje të lirë deri në informatat publike, Ligjin për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje, por edhe në Kodin zgjedhor.¹¹⁰

Turqia

Sundimi që nga viti 2002 i partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP) të presidentit aktual të Turqisë Recep Tayip Erdogan ka krijuar një lloj të komoditetit të qeverisjes ndër vite nga kjo parti. E konsideruar si e pa konkurrencë, shumë shpesh kjo qeveri u akuzua shpesh prej autoriteteve të ndryshme ndërkombëtare si shtypëse e të drejtave të njeriut dhe mos respektim të lirisë së shprehjes në veçanti. Në vitin 2016-të një puç ushtarak i dështuar, arsyt e të cilit përfundimisht ende nuk dihen se pse ndodhi dhe se nga kush ishte nxitur, pasoi me një aksion të paparë nga qeveria e Turqisë në arrestimin e mbi 50,000.00 qytetarëve. Ndër ta shumë gazetarë dhe aktivistë të shoqërisë civile¹¹¹.

¹⁰⁸ Liria e shprehjes dhe ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë : analizë krahasimore e kornizës ligjore/ Burim Ejupi, Dardan Abazi. – Prishtinë : Instituti për Politika Zhvillimore INDEP, 2015. – 21 cm.

¹⁰⁹ <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/macedonia>, qasur më 23/04/2019

¹¹⁰ Reporters without Borders, Country Report Macedonia, Freedom of the Press Index, <https://rsf.org/en/republic-north-macedonia>, qasur më 30/04/2019

¹¹¹ <https://www.dw.com/en/an-ongoing-crisis-freedom-of-speech-in-turkey/a-47405671>, qasur më 30/04/2019

Rreth 190,000.00 zyrtarë publik u pushun nga puna, ndërsa u mbyllën rreth 190 media. Të gjitha këto me pretendimin se ishin përkrahës të puçit dhe janë përkrahës të lëvizjes së Fetullah Gulenit. Raporti i fundit i Freedom House, do të rendit Turqinë si një vend jo të lirë me 31 pikë. Ndryshimet kushtetuese të vitit 2017, të cilat do të i japin kompetenca të shtuara presidentit nuk u pane me sy të mirë nga faktori ndërkombëtar. Ndërkohë vazhduan arrestimet dhe presioni i shtuar ndaj mediave edhe gjatë viteve pas puçit ushtarak.¹¹²

Shtesë, në raportin e vitit 2018-të të organizatës Reporters without borders që vlerëson sigurinë e gazetarëve dhe ambientin e favorshëm të ushtrimit të profesionit të gazetarës, Turqia renditet në vendin e 157-të, dy pozita më keq se në vitin 2017-të dhe gjashtë vende më poshtë se në vitin 2016-të. Në përmbledhjen e këtij raporti përmendet burgosja e gazetarëve dhe presioni i madh që po ju ushtrohet gazetarëve dhe mediave në ushtrimin e punës së tyre. Është shqetësues numri i madh i mediave dhe portale të mbyllura gjatë këtyre tri viteve të fundit¹¹³.

Suedia

Njëra ndër vendet që shquhet për demokracinë më të zhvilluar dhe vendi me respektim të lartë të të drejtave të njeriut është Suedia. Për disa vite me rradhë Suedia rradhitet në pozitat më të larta të raporteve ndërkombëtare që vlerësojnë lirinë e shprehjes dhe atë të medieve. Raporti i vitit 2017-të i organizatës Freedom House për Lirinë e medias e vlerëson Suedinë si një vend i lirë me gjithsej dhjetë pikë (me 0 vlerësohet vendi më i mirë). Sa i përket legjislacionit, ajo vlerësohet të ketë një legjislacion mjaft të avancuar dhe ambient shumë të favorshëm të punës për gazetarë. Brenga e cila ju është shfaqur viteve të fundit ka të bëjë me dy tema më të ndjeshme siç janë Islami dhe migrimi. Është vërejtur një tendencë e censurës së lehtë gjatë trajtimit të këtyre dy tema në mënyrë që mos të nxisin eventualisht ndonjë konflikt mes palëve¹¹⁴.

¹¹² Freedom House, Freedom of Press report 2018, Turkey, <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2019/turkey>, qasur më 30/04/2019

¹¹³ Reporters without borders, Freedom of the Press Index, Country Turkey, <https://rsf.org/en/turkey>, qasur më 30/04/2019

¹¹⁴ Freedom House report 2017, Country Sweden, <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2017/sweden>, qasur më 30/04/2019

Raporti tjetër i Reporterëve pa kufinj e rendit në vitin 2019-të, Suedinë në vendin e tretë, pas vendeve të të njëjtit regjion skandinav, si Norvegjia dhe Finlanda. Në përmbledhje ajo gjithashtu cek problemet në trajtim të temave kontraverse dhe disa sulmeve kryesisht online që i bëhen gazetarëve. Vlerësohet lartë edhe aktivizmi i qytetarëve për qasje në dokumente publike me qëllim të marrjes së informacioneve dhe për ti bërë më përgjegjëse institucionet. Derisa debat kishte ngritur financimi i televizioneve publike nga ana e shtetit dhe komercializimi i tyre përmes shërbimeve kablore duke u transmetuar në platforma të caktuara.¹¹⁵

Shtesë, Suedi vlerësohet të ketë legjislacionin më të vjetër në botë sa i përket Lirisë së mediave, të miratuar në vitin 1776-të.

Përmbledhje dhe rekomandime

- Nga ajo se çka u tha më lartë, mund të konkludojmë se liria e shprehjes jo rastësisht konsiderohet si një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në aspektin individual, kur njeriut i mohohet e drejta për të shprehur lirshëm atë se çka mendon, mund të mos ketë as kuptim esenca e ekzistimit dhe madje edhe mbijetesës në mesin e shoqërisë. Si pjesë e shoqërisë, ajo shoqëri të cilës i mohohet e drejta e lirisë së shprehjes, i mohohet edhe mundësia për një jetë më të mirë. Megjithatë hulumtimi në tërësi trajton më shumë aspektin individual gjithsesi, brenda një shoqërie dhe në raport me autoritetet publike.
- Hulumtimi vë në pah atë se legjislacioni sa i përket të drejtave të njeriut, lirisë së shprehjes në Kosovë është mjaft i avansuar dhe garanton një ambient të favorshëm për gazetarët për ta ushtruar profesionin e tyre. Megjithatë e thënë nga akterë të ndryshëm,

¹¹⁵ Reporters without borders 2019, World Press Freedom Index, Country Sweden, <https://rsf.org/en/sweden>, qasur më 30/04/2019

raporte vendore e ndërkombëtare, ajo që është brengosëse është zbatimi në praktikë i legjislacionit i cili lë shumë për të dëshiruar. Duhet mjaft punë në të gjitha sferat në mënyrë që zbatimi i ligjit të jetë në nivel të knaqshëm.

- Demokracia si një formë e organizimit dhe qeverisjes ku shumica në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur ushtron sovranitetin, përmes respektimit të të drejtave të njeriut mund të fuqizoj apo zhvilloj ndikimin më të madh. Ushtrimi i pushtetit nënkupton edhe përgjegjësi në qeverisje dhe ndaj popullit. Mos ushtrimi i drejtë i punëve dhe përgjegjësi publike mund të nxis reagime nga individët dhe shoqëria.

- Një vend i cili nuk e respekton të drejtën e shprehjes së lire të mendimit, rrjedhimisht ushtron diktaturë dhe nuk lejon përmirësimin e sistemit të qeverisjes. Shtesë, nuk mund të konsiderohet demokraci meqë ajo “shumicë” nuk lejon mundësinë e kundërshtimit dhe ndrrimit të kësaj “pakice”. Në vitet e para të pasluftës ishte i zbehtë numri i atyre të cilët kundërshtonin pushtetin, apo edhe i atyre që akuzonin për keqpërdorime të ndryshme. Gjithashtu ajo periudhë u shoqërua edhe me disa vrasje dhe incidente partiake, të cilat mund të zbehnin në përgjithësi ndjenjën e reagimit dhe shtypjen e lirisë së shprehjes.

- Megjithatë pas disa viteve kjo situatë filloj të përmirësohet. Të drejtat e njeriut në përgjithësi, e ajo e shprehjes në veçanti, filluan të trajtohen me seriozitet dhe të punohet në drejtim të njohjes së parë e pastaj edhe të respektimit të tyre. Shumë organizata joqeveritare e mekanizma ndërkombëtarë investuan në projekte e sisteme në Kosovë në temën e të drejtave të njeriut. Individët, qoftë si publicist, analist, por edhe gazetarë përmes punës dhe opinioneve të tyre fillojnë të shprehen lirshëm në lidhje me gjendjen socio politike por edhe për çfarëdo sferë tjetër në Kosovë.

- Në këto rrethana, rrjetet sociale e sidomos Facebook si mjet ndihmoi shumë që kjo praktikë të jetësohet dhe të zhvillohet. Në fakt, FB-ja si një platformë globale ka luajtur një rol crucial në zhvillimin e të drejtës dhe lirisë së shprehjes. Çdo njeriut ju krijua mundësia që pa asnjë presion të shpreh mendimet e tij/saj për çfarëdo çështje. Për të mos hyr më thellë pastaj në abuzimin eventual të kësaj platforme, për çështje të këtij studimi lartësohet vetëm

pjesa e të qenit mjet apo platformë për shprehje të mendimit. Andaj, shprehja e opinioneve dhe mendimeve në facebook dhe rrjete të tjera sociale rrit ndjeshmërinë e njerëzve krahas lirisë së shprehjes dhe njëkohësisht edhe përgjegjësinë e tyre publike dhe shoqërore.

- Ndërkohë mediumet, një tjetër platformë e cila ndihmoi shumë në lirinë e shprehjes, por edhe në lirinë dhe të drejtën e marrjes dhe dhënies së informacionit. Në vitet e fundit skena mediale u pasurua mjaft shumë me media, e sidomos me portale elektronike, tjetër mundësi kjo për të shprehur veten edhe profesionistë, gazetarë përmes punës së tyre por edhe qytetarë të rëndomtë duke raportuar e deklaruar raste. Disa shembuj janë platforma kallxo.com, një mundësi ku qytetarët mund të raportojnë në lidhje me rastet e korupsionit, krimit të organizuar, mashtrimeve të ndryshme dhe rrezikimit e cenimit të të drejtave të njeriut¹¹⁶. Kjo platformë e krijuar nga organizata Birn dhe Internews Kosova, organizata joqeveritare që gjithashtu monitorojnë gjykatat dhe kanë mbi dhjetëra gazetarë investigativ të cilët trajtojnë tema të “nxehta”. Gjithashtu edhe disa portale tjera kanë ofruar mundësi të raportimit të lajmeve/ngjarjeve por edhe rasteve të korrupsionit. Po krijohet dita ditës një lidhshmëri më e madhe në mes të qytetarit aktiv dhe medie. Kjo ndjenjë rrit ndjesinë e qytetarë për të qenë pjesë e qeverisjes dhe ndryshimeve eventuale shoqërore.

- Një sërë emisionesh investigative tema të rënda u trajtuan përmes emisioneve të ndryshme, shembuj të këtillë janë: Drejtësia në Kosovë, Jeta në Kosovë, #ZonaExpress, Indoks, etj. Shumë prej këtyre emisioneve edhe nxitën debate e reagime të shumta, shpeshherë të kulmuara edhe me fyerje e madje sulme ndaj gazetarëve, redaktorëve e TV të cilat i realizuan apo transmetuan. Efekti i këtyre emisioni duhet të jetë i dyfishtë: ajo që asnjë person, rast i dyshimtë keqpërdorimi nuk është i paprekshëm dhe mund të jetë subjekt i demaskimit, dhe demaskimi është mundësi për prokurorinë për hapje të hetimeve. Sa më shumë emisione të tilla dhe gazetari investigative kontribuon në demokracinë në përgjithësi dhe vetëdijësimin e njerëzve për rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe respektimin e kësaj të drejte.

- Në aspektin e artikullimit të lirisë së shprehjes në grup dhe ushtrimit të kësaj të drejte si kolektiv, organizimi i partive opozitare dhe aktiviteti i tyre i shtuar morri hov këto vitet e

¹¹⁶ www.kallxo.com, qasur më 10/12/2018.

fundit. Shumë tema të patrajuara dhe të cilat ishin tabu për një kohë filluan të shpalosen dhe të bëhen edhe debate publike. Kjo kishte efekt zingjir edhe te populli dhe qytetarët të cilëve mund të ju “hapej” rruga për diskutime të mëtutjeshme. Pra, rastet kur liria e shprehjes kolektive mund të ketë efekt domino në lirinë e shprehjes individuale. Andaj, duhet nxitur dhe inkurajuar debati i mirëfilltë edhe për tema të cilat janë heshtur për vite të tëra në këtë rast nga përfaqësuesit e popullit dhe ata të cilët janë të thirrur për mbrojtje të ligjeve dhe të kushtetutshmërisë.

- Duhet të ketë inkurajim dhe promovim nga institucionet për respektim të drejtës dhe lirisë së shprehjes. Jo rrallëherë kemi pas raste kur pikërisht autoritete publike, i kemi trajtuar edhe gjatë këtij hulumtimi kanë qenë subjekt i cenimit dhe rezikimit të lirisë së fjalës. Ky veprim, kjo praktikë vetëm se mund të kontribuoj në demotivim të qytetarëve për të shfrytëzuar këtë të drejtë, të garantuar me kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare. Nuk duhet të jetë vetëm dita ndërkombëtare për të drejtat e njeriut apo fushatat e ndryshme për poena politike, raste kur kërkohet respektimi i të drejtave të njeriut, por kjo kauzë duhet të jetë përgjegjësi dhe pjesë e përditshme dhe e pandashme e punës së të gjitha institucioneve, pa përjashtim.

- Puna e sistemit gjyqësor gjithë këto vite të pasluftës ka qenë temë diskutimi. Që nga pavarësia, mungesa e stafit, performanca, ishin disa nga problemet që janë identifikuar dhe që bëjnë sistemin gjyqësor të Kosovës mjaft të diskutueshëm. Numri i madh i lëndëve dhe mos trajtimi i tyre me kohë ka bërë që edhe shumë lëndë të parashkruhen. Shumë raste të sulmeve ndaj gazetarëve por edhe qytetarëve dhe rasteve kur është cenuar e drejta e lirisë së shprehjes kanë mbetur nëpër sirtare të gjykatave. Janë për tu përshëndetur veprimet e fundit nga kryeprokurori dhe prokuroritë themelore në lidhje me caktimin e prokurorëve që do të merren me rastet e gazetarëve por edhe premtimet për trajtimin e këtyre rasteve me më prioritet, megjithatë duhet angazhim shumë i madh i këtyre institucioneve që personat të marrin dënimin e merituar. Pra, bashkëpunimi dhe rritja e efikasitetit nga ana e policisë, prokurorisë, dhe gjykatave do të ndikonte pozitivisht në këtë rast që të drejtat e njeriut, liria e shprehjes të jenë të mbrojtura dhe të mos cenohen e shkelen në baza ditore. Sa i përket gjykatave, numri i rritur i gjyqëtarëve do të ndikonte që të gjitha lëndet të mund të trajtohen më mirë dhe më shpejtë e në këtë rast edhe ato të gazetarëve. Megjithatë kjo

kërkon ndërhyrje më rrënjësore dhe ndryshime më të thella në tërë sistemin gjyqësor e që indirekt do të ndikonte edhe në rastet e lirisë së shprehjes.

- Asociacioni i pavarur i gazetarëve të Kosovës, por edhe mediat e tjera dhe forumet e tjera ku gazetarët janë anëtarë dhe përfaqësojnë zërin e tyre duhet të jenë më të zëshëm në kërkesa e tyre dhe më aktiv në artikullimin e kërkesave dhe problemeve të tyre. Është duke u vërejtur një tendencë e “konkurrencës” jo të mirë dhe interesave biznesor edhe brenda këtij sektori, megjithatë duhet të kenë të qartë se vetëm si një forcë e bashkuar, grup i interesit i unifikuar mund të llobojnë në drejtim të përmirësimit të mjedisit ku po veprojnë dhe krijimin e një ambienti më të favorshëm për punë. Gjithashtu, vazhdimi i ngritjes së zërit në rastet e sulmeve ndaj gazetarëve duhet të vazhdojë, platforma e krijuar nga AGPK është një hap i qëlluar i cili duhet të mirëmbahet por patjetër të mendohet edhe për alternativa të tjera, metoda se si mund të bëhet më shumë në këtë drejtim. Shtesë, Asociacioni i Gazetarëve duhet të pretendoj që të rrisë shtrirjen sa më shumë dhe njëkohësisht pse jo të krijohen edhe asociacione e shoqata të tjera të gazetarëve qoftë edhe të profilizuar për të punuar për të mirën e përbashkët të këtij profesioni.

- Pjesa e biznesit së mediave më lartë është trajtuar vetëm në aspekt të unifikimit për lobim dhe kërkesa për kushte më të mira, megjithatë me qëllim që liria e shprehjes të respektohet dhe të merr trajtimin e duhur mos të keqpërdoret edhe mediet duhet të kenë një standard të lartë të raportimit dhe të politikave redaktuese. Kemi vërejtur se kemi raste kur me qëllim të përfitimeve personale përmes klikimeve disa media nuk i kushtojnë vëmendje cilësisë së lajmeve, nuk kanë ndonjë kriter të kontrollit të cilësisë, por postojnë vetëm gjëra që mund të nxisin kërshtërinë e lexuesve. Gjithashtu tjetër faktor është edhe shtrembërimi i deklaratave, ose me qëllim të tërheqjes së lexuesve pompoziteti i titujve të ndryshëm që në fakt janë larg me përmbajtjen dhe ngjarjen e vërtetë. Andaj, mediat duhet të kenë shumë kujdes dhe të krijojnë një standard qoftë edhe të pashkruar për të rritur kredibilitetin e tyre dhe për të mbrojtur fjalën e lirë.

- Gazetarët në anën tjetër duke raportuar drejtë dhe duke ngritur kapacitetet e tyre profesionale dhe intelektuale do të kontribuojnë në mbrojtjen e lirisë së shprehjes, dhënies së informacionit por edhe mbrojtjen e tyre personale dhe të punës së tyre në përditshmëri.

Puna e tyre është disa dimensionale, ata edhe informojnë publikun, japin informacionin e duhur por edhe raportojnë hulumtojnë për ngjarje, praktika raste të keqpërdorimeve, shpërdorimeve të detyrave, etj. Edukimi i tyre i vazhdueshëm, ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve por edhe bartja e eksperiencave dhe aplikimi i praktikave të mira të rajonit dhe Europës do të bënte që ata të jenë më profesional dhe të kryejnë detyrën e tyre në nivelet më të larta.

- Promovimi i rasteve të suksesit dhe inkurajimi i tyre duhet të jetë një hap tjetër që duhet ta ndjek shoqëria dhe institucionet publike. Njerëzit e guxishëm, aktivistët qytetarë, profesionistët e vërtetë duhet të promovohen në këtë shoqëri. Përmes këtij promovimi dhe duke çmuar këta njerëz synohet të arrihet efekti i replikimit dhe ofrimi i shembujve të mirë që duhet ndjekur. Aktualisht ka çmime të ndryshme të cilat i ofrohen specifikuisht gazetarëve, për storien më të mirë, guximin e tyre por edhe në përgjithësi njerëzve, qytetarëve që ndikojnë në forcimin e demokracisë në vend. Një çmim i tillë është edhe ai për demokraci, i cili ndahet nga KCSF në kuadër të projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA)¹¹⁷. Në vitin 2016-të ky çmim ju nda dy personaliteteve që mund të lidhen me temën e trajtuar.

- Çmimi i parë ju nda z.Murat Mehmeti, një punëtor i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) i cili përmes raportimeve të tij shpëfaqti keqpërdorimet milionëshe në këtë institucion. Përkundër presioneve që kishte por edhe rrezikut që mund të barte raportimi i tij, ai vazhdoi nuk u zbras dhe e përfundoi punën e tij deri në fund. Ndërkohë çmimi i dytë i takoi portalit insajderi.com, të cilët u shfaqën me një sërë hulumtimesh dhe raportimesh të guximshme kundër korupsionit dhe keqpërdorimeve e mashtrimeve nga autoritetet publike. Siç u përmend edhe më lartë te pjesa e sulmeve të gazetarëve, të dy bashkëthemeluesit dhe gazetarët e këtij mediumi janë sulmuar pikërisht për punën të cilën e kanë bërë. Përmes këtyre çmimeve, përveç nderimit dhe respektimit të punës së personave në fjalë synohet që atyre tu ipet edhe vullnet për të vazhduar tutje punën e tyre të mirë.

¹¹⁷<https://www.kcsfoundation.org/activity/sinjalizuesi-murat-mehmeti-dhe-portali-insajderi-nderohen-me-cmimin-per-demokraci/>, qasur më 12/12/2018, Prishtinë

○ Rasti i mësipërm i trajtuar si rast i suksesit i z.Murat Mehmeti ka të bëj me sinjalizuesit dhe më lartë në hulumtim është trajtuar edhe çështja e sinjalizuesve duke vlerësuar se Kosova tanimë ka një legjislacion mjaft të përshtatshëm sa i përket kësaj çështje. Marr shkas nga kjo autoritetet publike, organizatat qeveritare, gazetarët dhe hisedarë të tjerë të cilët merren me lirinë e shprehjes duhet të promovojnë dhe njoftojnë qytetarët në lidhje me ligjet që kontribuojnë në këtë të drejtë. Që një kohë të gjatë për shkak të përballjes gjithnjë e më shumë me tema të “rënda” si liberalizimi, demarkacioni, dialogu me Serbinë, shumë ligje e zhvillime të brendshme po kalojnë pa ju dhënë vëmendja e duhur. Andaj, meqë është vlerësuar si një ligj mjaft i rëndësishëm duhet organizuar fushata të ndryshme promovuese, debate dhe shpjegime në lidhje me benefitet dhe përparësitë që tani ligji i ri ju ofron “sinjalizuesve”. Nga rasti i z.Thaci të bankës Procredit kemi pas heshtje të rasteve të sinjalizuesve pikërisht për shkak të dënimit dhe pasojave që ata mund të kenë nga mungesa e legjislacionit specifik.

○ Edukimi i qytetarëve në përgjithësi në lidhje me rëndësinë e të drejtave të njeriut, lirisë së shprehjes por edhe rëndësinë e medieve dhe lajmeve të sakta e raportimit të drejtë. Qytetarët janë hisedarë shumë të rëndësishëm, për të mos thënë kryesorët në demokracinë në vend dhe kontributi i tyre në respektim apo rrezikim të saj është crucial. Në kapitullin e trajtimit të lajmeve të rreme, arritëm të shohim se sa të rëndësishme dhe në të njëjtën kohë të rrezikshme mund të jenë raportimet jo të drejta nga mediat. Specifikisht, edukimi në identifikim të lajmeve të rreme dhe identifikim të lajmeve, portaleve por edhe publikimeve kredibile nga ana e qytetarëve është me shumë rëndësi. Kjo mund të ndikojë në ndaljen e agjendave të dyshimta të cilat mund të shtyhen nga kushdo por edhe rritjen e profesionalizmit nga ana e medimeve për të postuar lajme serioze dhe të verifikuara.

Bibliografia

Legjislacioni:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi më 15 qershor 2008
- Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, NR. 04/L-44, 05 Prill 2015
- Ligji për Gjykatat, NR. 03/L-199, 28 Gusht 2010
- Ligji për Avokatin e Popullit, Nr. 05/L-019, 26.06.2015
- Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Nr.03/L-215, 25.11.2010
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

- Ligji për Mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, NR. 04/L-137, 23.08.2013
- Ligji për Gjykatën kushtetuese, NR. 03/L-121, 15.01.2009
- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, NR. 03/L-223, 03.11.2010
- Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare, NR. 04/L-57, 9.11.2011
- Ligji për Informim Për Qasje në Dokumentet Zyrtare, NR. 8503, Republika e Shqipërisë, 30.06.1999
- Ligji për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, NR. 97/2013, 15.03.2013
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

Webfaqe:

- <http://www.kqz-ks.org/>
- <http://www.kuvendikosoves.org/>
- <http://www.azquotes.com/>
- <https://en.wikipedia.org>
- <http://www.indiacelebrating.com/>
- <https://www.en.unesco.org/>
- <http://www.kryeministri-ks.net/>
- <http://www.unmikonline.org/>
- <http://www.kpm-ks.org/>
- <http://www.votaim.org/>

- <http://www.presscouncil-ks.org>
- www.psh-ks.net
- www.youtube.com
- www.agk-ks.org
- www.levizjafol.org
- www.koha.net
- www.gazetaexpress.com
- www.zeri.info
- www.insajderi.com
- www.magazina.al
- www.vushtrriaonline.net
- www.kcsfoundation.org
- www.kallxo.net
- www.wipo.int

Libra, buletin dhe aktvendime:

- Ahmet Ajeti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 213/2017, të 29-të gushtit 2017, Aktvendim për papranueshmëri, Ref: RK 1219/18, Gjykata Kushtetuese, 18 Prill 2018, Prishtinë
- Armend Selimi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PN-II-. nr. 8/2015, të 26-të nëntorit 2015, Aktvendim për papranueshmëri, Ref.RK1003/16, 14 Nëntor 2016, Prishtinë.
- Carol C. Gould 2004, Globalizing, Democracy and Human Rights, Cambridge University Press, New York.
- Case of E.S. v. Austria (Application no.38450/12) European Court of Human Rights, Strasbourg, 25 October 2018
- Case of Magyar Jeti ZRT v. Hungary (Application no.11257/16), European Court of Human Rights, Strasbourg, 04/12/2019.

- CASE OF MARCHENKO v. UKRAINE (Application no. 4063/04), EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS, 19 February 2009
- Case of Sahin Alpay v. Turkey (Application no.16538/17) European Court of Human Rights, Strasbourg, 20 March 2018
- Cox Archibald, Freedom of Expression, 1981, Harward University Press, London
- Doeblor Curtis, Introduction to International Human Rights Law, 2006, CD Publishing, Washington DC
- Doracak Organizimi dhe Funksionimi i Komisioneve Parlamentare, Xh. Hoxha, Sh. Haxhijaj, L. Ymeri, F. Hyseni, A. Ademaj, R. Beka, Sh. Kastrati, Prishtinë, Maj 2010
- Emancipi Civil Ma Ndryshe, Analizë e shkurtë, Transparenca e Qeverisjes Lokale në Prizren, Prizren, 2012.
- Golash, D. (2010). Freedom of expression in a diverse world. Dordrecht: Springer Netherlands.
- Gruda Zejnullah, Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, 2001, Universiteti i Prishtinës.
- Hamdi Ibrahim Vleresim i kushtetutshmerise se Vendimit te Keshillit Gjyqesor te Kosoves, KGJK/nr. 74/2016, te 6 korrikut 2016, Aktvendim për papranueshmëri, Ref: RK 1093/17, Qershor 2017, Prishtinë
- Islam Krasniqi Vleresim i kushtetutshmerise se Aktgjykimit te Gjykates se Apelit te Kosoves, A. A. nr. 2/2014, te 21 shkurtit 2014, Vendim për papranueshmëri, Ref RKS 856/15, 6 Nëntor 2015, Prishtinë
- K. C. O'Rourke, John Stuart Mill and Freedom of Expression The genesis of a theory, 2003, Taylor & Francis e-Library
- Kosovo 2.0, Çohu, KMSHK, Freedom of Expression, Media and Information in Kosovo An Assessment Based on Council of Europe Indicators for Media in a Democracy, 2015, Prishtinë
- Lëvizja FOL, Reforma Ligjore Kundërkorrupsionit, Analizë e Ligjit për Mbrojtjen e Informatorëve në Kosovë, 2015, Prishtinë
- Magee, J. (2002). Freedom of expression. Westport, Conn.: Greenwood Press.
- Mark Worth, Whistleblowing in Europe, Legal protections for whistleblowers in the EU, Transparency International, 2013, Berlin, Germany

- Mayrhofer, M. et al., 'International Human Rights Protection: Institutions and Instruments', (2014) FRAME Deliverable 4.1
- Melkonian Harry, Freedom of Speech and Society a social approach to freedom of expression, 2012, Cambia Press, United States of America
- Mykyreme Hoxha, Merita Hoxha, Mergim Hoxha dhe Blerim Hoxha Vleresim i kushtetutshmerise se aktgjykimit te Gjykates Komunale ne Peje, C. 90/03 te 09.01.2008, dhe te Aktgjykimit te Gjykates se Qarkut ne Peje, AC Nr. 313/2010 te 09.11.2011, Ref. Nr. RK438/13, Vendim për papranueshmëri 5 Korrik 2013, Prishtinë.
- Nader, Petkas, and Blackwell, Whistleblowing (1972).
- Radio Zeri i Sharrit kunder Vendimit A. nr. 2194/07 te Gjykates Supreme te Kosoves, i dates 12 shkurt 2009, Ref. Nr. RK53/10, Vendim për papranueshmëri, 15 Tetor 2010, Prishtinë
- Ralph E. McCoy, Freedom of the Press An Annotated Bibliography, 1958, Southern Illinois University Press.
- Tarlach McGonagle, Marie McGonagle, Ronan O Fathaigh, Liria e Shprehjes dhe Fyerja një studim i Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 2018, Këshilli i Evropës

Raporte:

- Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit
- Raporti i Freedom House
- Raporti i Freedom House për Maqedoninë
- Raporti i Freedom House për Shqipërinë
- Raporti i Freedom House për Turqinë
- Raporti i Freedom House për Suedinë
- Raporti i Human Rights Watch
- Raporti i Progresit i Bashkimit European
- Raporti i Reporterëve pa Kufinj
- Raporti i Reporterëve pa Kufinj për Maqedoninë
- Raorti i Reporterëve pa Kufinj për Turqinë
- Raporti i Reporterëve pa Kufinj për Suedinë

- Raporti i Transparency International
- Raporti nga Asociati i Gazetarëve të Pavarur të Kosovës
- Raporti nga Avokati i Popullit
- Raporti nga Prokuroria e Shtetit
- Raporti i UNDP-së, Puls i Publik
- Raporti i organizatës joqeveritare INDEP
- Raporti i organizatës joqeveritare YIHR
- Raporti i organizatës joqeveritare Kosovo 2.0
- Raporte të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut
- Raporti nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- Raporti nga Agjencia e Statistikave të Kosovës